REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

Nr 199 prot

Përmet, 23 / 01 /2025

Lënda: Dërgohet dokumentacion për shqyrtim dhe miratim

Znj Anila Dhimitri

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET

E nderuar Zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimet,relacionet shoqëruese si dhe dokumenta të tjerë shoqërues si më poshtë:

1.Për Përcaktimin e Kritereve për Familjet në Nevojë nga Fondi 6% dhe Fondi i Bashkisë

2.Për Miratimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok Ndihmës Ekonomike deri në 6%

3. Të Miratojë në Parim Vendosjen dhe Operimin e Stacionit të Trasferimit (ST) të Mbetjeve në Funksion të Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve Gjirokastër-Vlora Jug për Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë si dhe pjesë e Programit të BE për Ekonominë Qarkulluese-Programi Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve (EU4CE-REWAM)

4.Për Përbërjen dhe Fuksionimin e Komisionit të Strehimit Social në Bashkinë Përmet

5. Për Miratimin e Ndihmës Ekonomike për Familjet në Nevojë Muaji Janar 2025

6.Miratimin e Përdorimit të Fondit Rezerve për Dhënie Ndihmë Financiare

7.Për Miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Përmet 2025-2027.

8.Njohjen e Këshillit Bashkiak Përmet me Tarifat e Miratuara nga Enti Rregullator I Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujrave të Ndotura.

9.Miratimin e Listës së Përfituesve dhe Masën e Subvencionit të Interesave për Individë/Familje që përfitojnë Kredi të Lehtësuara nga Shteti për Kuotat e Miratura për Bashkinë Përmet

10. Njohjen Me Marrëveshjen Nr.72 Datë 13.01.2025, Midis Shërbimit Social Shtetëror Dhe Bashkisë Përmet Dhe Implementimin E Projektit "Përqafimi I Shpresës Një Oaz Për Ata Që Kanë Nevojë".

Me respekt,

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**Nr._______Prot** **Përmet më.____/____/2025**

**P/ VENDIM**

**PER PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA FONDI 6% DHE FONDI I BASHKISË**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore",të ndryshuar,të ligjit nr.57/2019,"Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë",të vendimit nr.597,datë 04.09.2019,të Këshillit të Ministrave"Për përcaktimin e procedurave,të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike"të ndryshuar.
Familjet do të përzgjidhen në bazë të kritereve të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe masa e pagesës do të llogaritet në bazë të Udhëzimit Nr. 4 datë 17.02.2017.
Kriteret e përcaktuara për familjet në nevojë dhe që do të trajtohen nga fondi 6% dhe nga fondet e akorduara nga Bashkia.

**VENDOSI**

1. Familje me një prind me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë.
2. Persona të vetmuar në moshë para pensionit dhe s'kanë të ardhura të tjera.
3. Familje me më shumë se një fëmijë të lindur njëherësh (binjakë, trinjakë, katërnjakë) dhe pa të ardhura financiare.
4. Familje të divorcuara të cilat janë me urdhër mbrojte nga gjykata.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË**
Alma HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**Nr.________prot.** **Përmet më____.____.2025**

**P/VENDIM**

**Per miratimin e fondit te kushtezuar per bllok ndihmes ekonomike, deri ne 6% .**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republiken e Shqiperise, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore " i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 "Per disa ndryshime ne Vendimin 597 dt.04.09.2019 te K.M."Per percaktimin e proçedurave, dokumentacionit dhe mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditesuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.107 date 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj". Keshilli Bashkiak,me propozim te Kryetares se Bashkise:

**VENDOSI**

1.Te perfitojne ndihme ekonomike per Muajn Dhjetor **2024**, **6** familje me nje fond prej 21.184 **leke.**

2. Familjet qe perfitojne jane si me poshte:

| Nr | Emri, Atesia, Mbiemri | Bashkeshortja/i | N.ant. | Shuma |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ylli Guçe Pelushaj | Zylkade Qerim Pelushaj | 2 | 3.703 |
| 2 | Roland Petraq Jorgji | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| 3 | Lame Enver Ferati | Silvana Kujtim Ferati | 3 | 5.227 |
| 4 | Mimoza Skender Gjoka | Divorcuar | 1 | 2.178 |
| 5 | Lefteri Mihal Tyto | Divorcuar | 1 | 5.720 |
| 6 | Flavia Musa Pelushaj | Beqare | 1 | 2.178 |
| | **SHUMA** | | | **21.184** |

3..Ngarkohen per zbatimin e ketij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmes ekonomike.

**KRYETAR I BASHKISË**
**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

Sheshi "Abdyl Frashëri";tel.+35581322254; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**Nr.________prot.** **Datë___.____.2025**

# RELACION

## PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI JANAR 2025

Në mbështetje te ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republiken e Shqiperisei ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për percaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Familje te cilat janë përfituese në fondin e bashkise jane ato familje te cilat mbasi kane bere aplikimin ne Sistemin e Ndihmes ekonomike, rekomandimin ne fondin 6% nuk jane fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje duke parë gjendjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjendje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevoje.

**Përsa me sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Janar 33 familje me një vlerë prej 81.878 lekë.**

**Specialisti i NE**

Jurigen SIMONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

Nr.________prot.                                                                 Datë___.____.2025

**P/VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI JANAR 2025**

Në mbështetje te ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republiken e Shqiperisei ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për percaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

**VENDOSI**

1.Të perfitojne ndihme ekonomike per Muajn **JANAR** 2025, **33** familje me nje fond **81.878 lekë.**

2.Fondet te perballohen nga struktura :

**1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.01.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 81.878 leke**

3. Familjet qe perfitojne jane si me poshte:

| Nr | Emri, Atesia, Mbiemri | Bashkeshortja/i | N.ant. | Shuma/leke |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ziso Apostol Kristo | Valentina Polikron Kristo | 3 | 2400 |
| 2 | Xhilda Xhemal Selimllari | Xhilda Xhemal Selimllari | 2 | 2700 |
| 3 | Mitro Gani Zeqiri | Lefteri Rrapi Zeqiri | 4 | 3000 |
| 4 | Syrja Mehmet Hoxha | Beqar | 1 | 2600 |
| 5 | Drita Irakli Kosta | Divorcuar | 2 | 2100 |
| 6 | Lefteri Polikron Proko | E ve | 1 | 3000 |
| 7 | Andon Dhimitraq Kukureci | I ve | 2 | 3000 |
| 8 | Aferdita Nuredin Lahe | Beqare | 1 | 1800 |
| 9 | Arben Thoma Teka | Mirela Xheli Teka | 6 | 3000 |
| 10 | Viktor Josif Proko | Divorcuar | 1 | 1800 |
| 11 | Dhimo Naun Dimçi | Lindita Hysen Dimçi | 3 | 2400 |
| 12 | Vera Thanas Naqe | E ve | 2 | 2100 |
| 13 | Leonart Petro Markaj | Kristina Petraq Markaj | 3 | 2100 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 14 | Thoma Aristidh Ilia | Maria Nuredin Ilia | 4 | 3000 |
| 15 | Xhensila Maksim Jahjaj | Beqare me Femijë | 2 | 2600 |
| 16 | Violeta Guce Pelushi | Beqare | 1 | 1800 |
| 17 | Engjellushe Manxho Canollari | E ve | 1 | 3000 |
| 18 | Rivelino Fatmir Doko | Hurma Leonidha Doko | 4 | 3000 |
| 19 | Bajame Fari Hysenshahaj | E ve | 1 | 1800 |
| 20 | Lida Koco Thomollari | Divorcuar | 1 | 2600 |
| 21 | Vasilika Bedri Malka | E ve | 2 | 2400 |
| 22 | Ilir Sali Jashari | Beqar | 1 | 1800 |
| 23 | Vitori Llazo Caci | Beqare | 2 | 2100 |
| 24 | Luam Ferit Zeneli | Gezime Tafil Zeneli | 4 | 3000 |
| 25 | Ilber Kudret Dalipaj | Divorcuar | 1 | 1800 |
| 26 | Kastriot Kristo Koto | Kastriot Kristo Koto | 3 | 3000 |
| 27 | Kastriot Astrit Male | Divorcuar | 1 | 2178 |
| 28 | Vangjush Thanas Mamillo | Gentiana Seit Mamillo | 3 | 3000 |
| 29 | Bari Avni Zaimi | Valbona Zenel Zaimi | 2 | 2100 |
| 30 | Kadri Petrit Maska | Beqar | 1 | 2600 |
| 31 | Dashnor Guçe Pelushaj | Vezire Ali Pelushaj | 4 | 3000 |
| 32 | Klodiana Kristofor Peçi | Divorcuar | 1 | 2100 |
| 33 | Lulëzim Barjam Beqari | Divorcuar | 1 | 3000 |
| | **SHUMA** | | | **81.878** |

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Sektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**
**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**Nr.________prot.** **Datë___.____.2025**

# RELACION

## PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI JANAR 2025

Në mbështetje te ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republiken e Shqiperisei ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për percaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.107 datë 18.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2025 dhe percaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Familje te cilat janë përfituese në fondin e bashkise jane ato familje te cilat mbasi kane bere aplikimin ne Sistemin e Ndihmes ekonomike, rekomandimin ne fondin 6% nuk jane fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje duke parë gjendjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjendje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevoje.

**Përsa me sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Janar 33 familje me një vlerë prej 81.878 lekë.**

**Specialisti i NE**

Jurigen SIMONI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

## P/ VENDIM

## TË MIRATOJË NË PARIM VENDOSJEN DHE OPERIMIN E STACIONIT TË TRANSFERIMIT (ST) TE MBETJEVE NE FUNKSION TE ZONES SE MENAXHIMIT TE MBETJEVE GJIROKASTER – VLORA JUG PËR BASHKITE PËRMET DHE KËLCYRË, SI PJESË E PROGRAMIT TË "BE PËR EKONOMINË QARKULLUESE – PROGRAMI RAJONAL I MENAXHIMIT TË MBETJEVE (EU4CE-REWAM).

Këshilli Bashkiak Përmet mbledhur më dt.___/___/2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 23 pika 10 të Ligjit Nr.139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit nr. 10 463, datë 22.9. 2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" i ndyshuar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013 dhe Ligji nr. 92 datë 22.09.2016, Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta - Strategjia Sektoriale -i Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020, Vendimit nr. 418, datë 27.5.2020 "Për Miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035". VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" Ligjit nr.107/2014 datë 01/10/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, si dhe relacionin e paraqitur nga grupi i menaxhimit të mbetjeve, pas diskutimeve

**VENDOSI:**

1- Të miratojë në parim vendosjen dhe operimin e Stacionit të Transferimit (ST) te mbetjeve ne funksion te Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve Gjirokaster – Vlora Jug për Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë, si pjesë e Programit të "BE për Ekonominë Qarkulluese – Programi Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve (EU4CE-ReWaM).
2- Vendi i propozuar i ndërtimit dhe funksionimit të këtij Stacioni do të jetë në teritorin e Bashkisë Këlcyrë sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij projekt-vendimi, dhe është pjesë përbërëse e tij.
3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.
4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË**
**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

Njësia Bashkiake e Menaxhimit të Mbetjeve

RELACION

**Për miratimin në parim vendosjen dhe operimin e Stacionit të Transferimit (ST) te mbetjeve ne funksion te Zones se Menaxhimit te Mbetjeve Gjirokaster – Vlora Jug për bashkite Përmet dhe Këlcyrë, si pjese e Programit të "BE për Ekonominë Qarkulluese – Programi Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve (EU4CE-ReWaM).**

***Të nderuar Këshilltarë***

***Hyrje***

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Manaxhimin e ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Shqipërisë për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve, duke synuar minimizimin e impaktit të mbetjeve në mjedis në nivelin kombëtar dhe lokal si dhe përmirësimin e përdorimit efiçient të burimeve në Shqipëri. Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve për të transformuar statusin e vendit në lidhje me grumbullimin e menaxhimin e mbetjeve, riciklimin, kompostimin apo përpunimin me përfitim energjie. Ajo ka vendosur objektiva sfidues dhe realiste njëkohësisht, të cilët synojnë mundësimin e ndryshimit rrënjësor të mënyrës së menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Menaxhimi i mbetjeve është një sfidë e madhe në Shqipëri dhe kontribuon ndjeshëm në emetimet e gazrave sere. Kjo nga ana tjetër dëmton potencialin turistik të vendit i cili përbën 18% të PBB-së. Ndaj qeveria e ka shpallur menaxhimin e mbetjeve një sektor strategjik dhe prioritar.

Programi i "BE për Ekonominë Qarkulluese – Programi Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve (EU4CE-ReËaM) i financuar plotësisht nga BE-ja dhe i zbatuar nga AFD-ja (Agjencia Franceze për Zhvillim, në partneritet me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë, ne zbatim te Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta - Strategjia Sektoriale

Projekti EU4CE-REËAM po zbatohet në një shkallë nënkombëtare me përfitues përfundimtarë edhe bashkitë e Qarkut Gjirokastër dhe Vlora Jugore të Qarkut të Vlorës

***Niveli Vendor.*** Në nenin 23 pika 10 të Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e NJQV-ve në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. Në mënyrë të veçantë, grumbullimi, transportimi dhe asgjesimi, si edhe trajtimi i mbetjeve bashkiake përcaktohet si funksion i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë e menaxhimit të ofrimit të shërbimit në një mënyrë që i përshtatet më së miri kushteve të tyre specifike. Detyrat e veçanta të menaxhimit të mbetjeve për bashkitë dhe këshillat rajonalë janë të përcaktuara në ligjin Nr. 10463/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" i ndryshuar, dhe në disa akte nënligjore që rrjedhin nga ky ligj. Instrumenet e planifikimit në nivel vendor përfshijnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat duhet të jenë në harmoni me planet përkatëse kombëtare dhe rajonale të menaxhimit të mbetjeve. Në nivel vendor, shërbimet e MMN ose zbatohen nga bashkitë me personelin dhe me pajisjet e tyre ose nga kontraktorë privatë.

REPUBLIKA E SHQIPËR

***Shkurtime***

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
Agjensia Kombëtare për Ekonominë e Mbetjeve (AKEM)
Zonat e menaxhimit të mbetjeve (ZMM)
Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta (MIMN)
Plani Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve (PRMM)
Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU)
Rregullorja për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Përmet (RRMMNU)
Stacion transferimi (ST)
Agjencinë Franceze për Zhvillim (AFD).

***Të dhëna të përgjithëshme funksinimin e Stacionit të Transferimit (ST).***

Ngritja e sistemit të grumbullimit të mbetjeve nga bashkitë, është një hallkë shumë e rëndësishme në zinxhirin e menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkiakete parashikuara në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Si pjesë e Projektit Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta financuar nga BE-ja në Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve Gjirokastër dhe Vlorë Jug, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) është tashmë në procesin e përcaktimit të vlefshmërisë së vendeve të përzgjedhura për infrastrukturen rajonale dhe të Sistemit Rajonal të Mbetjeve. Aktualishtë është bërë vlerësimi paraprak dhe propozimi për vendndodhjen e vendeve që do të konsiderohen për të ndërtuar Stacionet Transferimit (ST) të propozuara, dhe potencialisht infrastruktura shtesë sic mund të jenë Qendrat për Mbetjeve Voluminoze - Ishuj Ekologjik, (termi në anglisht Civic Amenity Centers). Kryerja e vëzhgimeve paraprake teknike, mjedisore dhe sociale (për të identifikuar nëse ka ndonjë rrezik teknik, mjedisor ose social të lidhur me vendndodhjen e vendit të propozuar.

*Zona e propozuar ku do te ngrihet dhe funksionojë Stacioni i Transferimit (ST).*




*Pozicioni horografik i zonës se propozuar per ndertimin e ST*

Objekti ndodhet jashtë territorit të Bashkisë Përmet, ne kufi me territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe ndodhet me koordinata (40°17'32.57"N - 20°14'25.53"E). Eshte lehtesisht i aksesueshem pasi ndodhet prane rrugës nacionale Përmet-Kelcyrë, ka infrastruktures rrugore deri tek ST e cila duhet përmirësuar. Vëndi ku ndodhet objekti zona e ndërtimit është në pronësi shtetërore.



*Harta e Planit Kombëtar Sektorial Për menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta*




Harta e ZM Vlorë Jug-Gjirokastër







Zona e menaxhimit te mbetjeve Vlora Jug, dhe Qarku Girokaster

### *Të dhëna teknike mbi ndërtimin e ST*

Stacioni transferimt (ST) për nje funksion normal në raport me sasine e mbetjeve që do të transferohen duhet të këtë nje siperfaqe mesatarisht 1500 m2, kjo ne varësi të sip që do të jetë në dispozicion për ndëtimin dhe funksioimin e tij.

Funksionimi i këtij ST do të jetë: Makina teknologjike shkon në Stacion peshohet dhe me pas shkarkon mbetjet në një bunkier (hinkë) te cilat bien në nje kontenier i cili qëndron poshtë hinkës dhë me renien e mbetjeve ai edhe i preson. Me mbushjen e ketij kontenieri ai terhiqet per ne destinanacionin e dytë që është Stacioni rajonal i parashikuar në "Tërbuq" Gjirokaster dhe me pas mbetjet cohen per në destinacionin final Landifillin e Bajkajt. Vlera e ndërtimit të këtij ST i përket projektit.

### *Funksionimi i këtij Stacioni*

Eshte parashikuar që në nivel rajonal dhe në nivel Qarku të ngrihet dhe funksionojë një bord ne përbërje të cilit do të jenë Kryetaret e Bashkive, Kryetari i Qarkut, edhe instiucione te tjera të cilat do të përcaktojnë rregulla mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit te ST, dhe Stacionit Rajonal.

*Pamje ilustruese te ndertimit dhe funksionimit te ST*



***Aspekti ligjor dhe institucional.***

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve, Zona e Mbetjeve Vlorë Jug – Gjirokastër mbulon Bashkitë Himarë, Delvinë, Sarandë, Finiq dhe Konispol të Qarkut Vlorë dhe të gjithë Qarkun Gjirokastër. si dhe në kuadër të Planit Rajonal për menaxhimin e mbetjeve në ZMM Gjirokastër – Vlora Jug, si pjesë e projektit EU4RËM të inicjuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe kontributin e BE dhe Agjensise Franceze për Zhvillim (AFD) pjesë e së cilës është edhe Bashkia e Përmetit, është parashkuar ndërtimi i një Stacioni Transferimi (ST) për dy Bashkitë (Përmet-Këlcyrë). Ndërtimi i këtij ST i cili shpresojmë se do të realizohet shumë shpejt, do bëjë të mundur mbylljen e vënd-depozitimit aktual në Piskovë.

Vend depozitimi sanitar në Bajkaj është në funksionim që nga viti 2015. Vend depozitimi Sanitar i Bajkajt është krijuar për ti shërbyer një zonë mbulimi, e cila mbulon tërë pjesën jugore të rajonit të Vlorës, përkatësisht bashkitë Delvinë, Finiq, Himarë, Konispol dhe Sarandë. Edhe pse është projektuar për të marrë më shumë se 70 tonë mbetje në ditë, vend depozitimi i Bajkajt aktualisht merr vetëm 35 tonë në ditë.

Bashkia Përmet në kuadër të projektit "Bashki të Forta", projekt i Agjencisë Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim SDC, zbatuar nga Helvetas ka hartuar Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) 2024-2029, i cili është miratuar me VKB Përmet nr.42 date 07.06.2024, si një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet. Gjithashtu me VKB nr.75 date 31.10.2022 është miratuar Rregullorja për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Përmet.

**Bashkëpunimi ndërmjet Autoriteteve**

Funksionimi i ST do të kërkojë një marrëveshje bashkëpunimi midis dy Bashkive Përmet-Këlcyre për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ST lokal. Po kështu të dyja Bashkite Përmet dhe Këlcyrë qe do të qyhen nje zonë lokale menaxhimi mbetjesh dotë jene pjesë e "bordit" rajonal dhe atij në nivel Qarku.

***Përfitimet nga funksionimi i këtij stacioni transferimi.***

1) Realizimi i objektivave të vendosuara në kuadrin ligjor për menaxhimin e mbetjeve urbane, për të cilat Bashkia ka detyrim.
2) Mbyllja e vënd-depozitimit aktual në Piskovë me vënien në funksion të këtij ST
3) Rehabilitimi i vënd-depozitimit në "Brackovë" si pjesë e këtij projekti.
4) Përmirësimi i ndjeshëm i territorit të Bashkisë, natyrës së tij, pasi nuk do të ketë vënd-depozitime të mbetjeve urbane.
5) Evitimi i ngjarjeve të zjarreve apo fenomeneve te tjera si ndotja, aroma, efekti viziv në vënd-depozitimin aktual.
6) Ulja e shpenzimeve per mirëmbajtjen e vëndepozitimit (ngjeshje e mbetjeve, mbulimi me "dhe" i shtresave, mirëmbajtja e kanaleve anësorë, etj)
7) Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me mbetjet urbane, për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen ne ST dhe më pas në atë përfundimtar.

***Rrisqet që vijnë si rezultat i ngritjes dhe operimit të këtij stacioni***

1) Rritja e kostos së transportit të tyre aktualisht nga vënd-depozitimi i Piskovës deri në ST i propozuar me 6 km, në një drejtim ose 12 km shtësë transporti me mjetet teknologjike.

EPUBLIKA E SHQIPE

2) Kosto e transportit dhe operimi i Stacionit Rajonal "Tërbuq" Gjirokaster. (Këto vlera do të përcaktohen nga bordi qe do te ngrihet dhe funksionoje ne rang Rajonal i përbërë nga përfaqësues të ZMM Gjirokastër)

**2.a.** Hartimi dhe miratimi i Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) si dhe Rregullorja për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë Përmet (RRMMNU) përvec detyrimit ligjor kane si objketiv uljen e sasise së mbetjeve të cilat aktualisht grumbullohen dhe depozitohen mix nëpërmjet sektorit publik te pastrim-gjelberimit.

**2.b.**Me qëllim uljen e sasisë së mbetjeve të cilat do të transportohen si fillim në ST në Këlcyrë dhe më pas në Stacionin Rajonal Tërbuq Gjirokaster, bazuar në Marreveshjen e Bashkepunimit midis Bashkise Permet dhe Projektit te GIZ (BE per Ekonomine Qarkulluese dhe Ekonomia Qarkulluese per Zhvillimin Urban te Qendrueshem), eshte vendosur qe ne Bashkine Permet te ngrihet nje Qender burimore per rikuperimin e mbetjeve te riciklueshme te thata dhe te grumbulluara nepermjet nje skeme te vecante te grumbullimit te mbetjeve te riciklueshme ne burim, projekt i cili ka kaluar ne Keshillin Bashkiak dhe është në proces miratimi i lejes se ndertimit dhe me pas zbatimi i tij

**2.c.** Objektiva të arritshëm afatshkurter me qellim minimizimin e sasisë së mbetjeve që do të transportohen ne ST dote jenë edhe grumbullimi dere me dere, percaktimi i vendeve per mbetjet voluminoze, mbetjeve te gjelberta , mbetjeve inerte etj.

**Njësia Bashkiake për menaxhimin e mbetjeve në ZMM Gjirokaster.**

**Përbërja:**

1) Marsela **KAPLLANI** (*Përgjegjese e Urbanistikës dhe Planifikimi të territorit*)

2) Arian **JAUPI** (*Specialist i Shërbimeve Publike*)

3) Adriatik **BAKUSHI** (*Specialist Hartograf, Zyra e urbanistikes*)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

**P/VENDIM**
Nr._____ dt.____/___/2025

# PËR
# PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT SOCIAL NË BASHKINË PËRMET

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja"b", nenit 24, nenit 54, shkronja"k", të ligjit nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore", Vendim nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Vendim nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti" VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", VKM nr 405 datë 01.06.2016 "Për miratimin e strategjisë së stehimit social 2016-2025" pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni konsultativ i strehimit, Zyra e Shërbimeve Publike, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë social, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I :**

**Të miratojë ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit Social në Bashkinë Përmet.**

1. Pranë Bashkisë Përmet ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit Social.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe mer vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga cdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe cdo Çështje tjetër që parashikohet nga legjslaconi për strehimin apo akteve të tjera ligjore e nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i strehimit përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:
    1. Nënkryetari i Bashkisë. Kryetar
    2. Drejtori i Strukturës Përgjegjëse për Mbrojtjen dhe Përfshirjen Sociale. Zv..Kryetar
    3. Përfaqësues i Drejtorisë Juridike. Anëtar
    4. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Finances Anëtar
    5. Specialisti i Strehimit. Anëtar
4. Komisioni i Strehimit asistohet nga Zyra për Çështjet Sociale dhe e Shërbimeve Publike të cilat asistojnë komisionin gjatë gjithë veprimtarisë së tij, dhe janë përgjegjëse për:
    a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe

vendimmarrjes së Komisionit;

b. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
c. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
d. Njofton Kryetarin e komisionit për çdo kërkesë të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të kërkesës/aplikimit;
e. Dhënien e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasqyrohet në proces-verbalin e mbledhjes;
f. Mban, harton dhe nënshkruan process-verbalin e mbledhjes;
g. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
h. Ruan konfidencialitetin.
i. Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Kryetari apo Komisioni i Strehimit.

**5.** Drejtoria Juridike, e Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë komision.

**6.** Ngarkohen Komisioni i Strehimit, Nënkryetari i Bashkisë, Zyra e Shërbimeve Sociale, Zyra e Financës, Zyra e Shërbimeve Publike Zyra Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Tërritorit, Zyra e Nd.Ekonomike dhe Kujdesit Social për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

**RELACION**

**NË LIDHJE ME PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT SOCIAL NË BASHKINË PËRMET**

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak Përmet.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja"b", nenit 24, nenit 54, shkronja"k", të ligjit nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 "Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar Strehimsipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore", Vendim nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Vendim nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti" VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", VKM nr 405 datë 01.06.2016 "Për miratimin e strategjisë së stehimit social 2016-2025" paraqesim për shqyrtim relacionin Këshilli Bashkiak, në lidhje me përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Përmet si më poshtë:

**A. Të përgjithëshme:**

Programet sociale të strehimit, janë programe, të cilët shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Këto programe janë objekt i veprimtarisë së këtij Komisioni. **Ky komision në përputhje me normat juridike, sa herë ka në zbatim një program social strehimi,do të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin për të bërë të mundur , vlersimin teknik sipas sistemint të pikezimit të miratuar në Këshill Bashkiak , të listës emërore të personave aplikues, me qëllim sigurimin e trasparencës dhe efiçences së tij,si organ kolegjial përballë aplikuesëve.**

I. Cilat janë programet sociale të strehimit sipas legjislacionit të strehimit social?

a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;
b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;
*d) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;*
*e) programi për krijimin e banesave të përkohshme;*
*f) programi i banesave të specializuara.*

Komisioni i strehimit social do të ketë në veprimtarinë e tij vlerësimin e kërkesave të aplikuesëve si dhe pëcaktimin e listës së përfituesëve në programet të cilat zhvillohen nga Bashkia.

### II. Cilat janë rregullat e përzgjedhjes që aplikohen nëpërmjet sistemit të pikëzimit?

1. Përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
2. Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato.
4. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojë listat e përfituesve brenda një afati dymujor, nga data e njoftimit nga ana e subjektit publik ose privat që ofron dhe realizon një nga programet sociale të strehimit, kur ky subjekt nuk është vetë njësia e vetëqeverisjes vendore. Marrëdhënia e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit që financon projektin përcaktohet me marrëveshje të posaçme.
5. Hartimi i listës së përfituesve kryhet nga zyra përgjegjëse ose struktura e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

### III. Cilat janë kriteret e përzgjedhjes së përfituesve?

Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve/familjeve përfituese, për hartimin dhe miratimin e sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e mëposhtme:
a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që: i) nuk disponojnë banesë në pronësi; ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje; iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi; iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore; v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor; vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.
b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi: i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna; ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

### IV. Verifikimi i gjendjes ekonomike dhe sociale të familjes

*Mënyra e verifikimit*
1. Mbështetja nga buxheti i shtetit dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore për përfituesit nga programet sociale të strehimit jepet pas verifikimit të gjendjes ekonomike e financiare të familjes.
2. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes kryhet nga administratorët shoqërorë, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.

### B. Programet e strehimit social të cilat aplikohen në Bashkinë Përmet.

#### a) *programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;*

*Cfarë është programi i banesave sociale me qera?*

Programi i banesave sociale me qira është programi, me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social. Banesat sociale me qira përfshijnë:

a) **banesat sociale që ndërtohen** ose blihen nga tregu i lirë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim që të jepen me kontratë qiraje sociale;
*b) banesat ekzistuese në treg, në pronësi të pronarit social;*
*c) objektet e dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes së një veprimtarie, të cilat kanë kaluar në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe, në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, janë miratuar për t'u kaluar në fond banesash sociale me qira, që subvencionohen.*

**b) *programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri***

*Cfarë është programi për përshtatjen e përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave?*

Me përmirësim të kushteve të banesave ekzistuese dhe, nëse është e nevojshme, deri në ndërtim të ri, kuptohet tërësia e punimeve që duhet të kryhen, me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm, sipas kushteve të parashikuara në nenin 4 të ligjit 22/2018

*Cilët janë përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit?*

Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.
2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:
a) personat me aftësi të kufizuara;
b) individët me statusin e jetimit;
c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
ç) të moshuarit;
d) komuniteti rom;
dh) komuniteti egjiptian;
e) komunitetet e zonave rurale;
ë) prindërit e vetëm;
f) viktima të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit;
g) viktima të dhunës në familje.

*Cilat janë objektet/banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve?*

Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve ose i përmirësimit të kushteve deri në ndërtim të ri, janë:
a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;
b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.
2. Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

**c) *programi i banesave me kosto të ulët, nëpërmjet Subvencionimit të interesave të kredive?***

*Cfarë është programi i banesave me kosto të ulët?*

Banesë me kosto të ulët konsiderohet banesa që plotëson të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi, që është e paracaktuar për t'u disponuar në pronësi nga përfituesi, nëpërmjet formave të ndryshme të lehtësimit nga institucionet shtetërore.
Banesat me kosto të ulët që sigurohen nëpërmjet ndërtimit, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku vlerat e tregut janë më të larta se kostoja e ndërtimit, shiten me çmim nën vlerën e tregut, por jo nën vlerën e kostos së ndërtimit.

Banesat me kosto të ulët sigurohen nga subjekte publike ose private, nëpërmjet ndërtimit ose blerjes nga tregu.
Banesat me kosto të ulët mund të financohen: -me fondet e buxhetit të shtetit, -me fondet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, -fondet e institucioneve publike, -nëpërmjet donacioneve e kredive dhe -nëpërmjet nxitjes së nismës private.
Për lehtësimin e blerjes së BKU-së nga përfituesi përdoren instrumentet financiare të mëposhtme: a) granti i menjëhershëm; dhe/ose b) subvencioni i interesave të kredive.
Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore me kushte lehtësuese nga një institucion financiar, që ka lidhur marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për strehimin, ministrinë përgjegjëse për financën ose me njësinë e vetëqeverisjes vendore. Kuota nga Ministria e financave per Bashkine Përmet eshtë për 14 familje për kredi të lehtesuar.

**d) Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët**

Përfituesit e grantit të menjëhershëm janë familjet të cilat kanë në përbërje:
a) një person me aftësi të kufizuar, në përputhje me përcaktimet në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;
b) një individ me statusin e jetimit, i cili, në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç;
c) kryefamiljarin e vetëm, në rastin kur ka në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç;
ç) familjet e komunitetit rom dhe egjiptian.

Shuma e grantit të menjëhershëm, që përfiton individi, është në masën 10 për qind të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.

## V. Përfundime:

Komisioni i strehimit ka në objektin e veprimtarisë së tij vleresimin e kerkesave të programeve sociale të strehimit të cilat zhvllohen në Bashkinë Përmet si dhe hartimin e listës përfundimtare të përfituesëve dhe paraqitjen e saj për miratim në Këshillin e Bashkisë, sipas nenit 15, pika 5 të Ligjit Nr.22/2018"Për strehimin social" i ndryshuar. Me miratimin e listës në Këshillin e Bashkisë, Sektori i Strehimit menjeherë pas marrjes të listës së vlerësuar, njofton familjet dhe individët për vlersimin përfundimtarë të kryer nga komisioni i Strehimit.

***Duke ju falenderuar***

**Komisioni Konsultativ:**

Kryetar Aulona Meshini

Anëtar Arian Jaupi

" " Arjana Papapano

" " Jurgen Simoni

" " Pavlina Hormoviti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - BASHKIA PËRMET

**REPUBLIKA E SHQIPËRIS**

**BASHKIA PËRMET**

**P/VENDIM**

**Nr__________ Prot** **Datë _____._____.2025**

## Për

# MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " ,Ligjin Nr. 68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ",Ligjin 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financjar dhe kontrollin" i ndryshuar , Ligji Nr.115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025", Vendimi i KB Nr.107 datë 18.12.2024 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2025" dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj", , Vendim Nr. 89, datë 14.02. 2018 Për Miratimin e Kushteve dhe përcaktimin e Rregullave për Transportin Rrugor të Nxënësve të Arsimit Parashkollor, Profesional, Parauniversitar dhe të Studentëve,Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

## V E N D O S I

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara ( për dhënie ndihme financiare ) në masën 341000 ( treqind e dyzetë e një mijë ) lekë. për sa më poshtë vijon:

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Agathii | Altin | Dako | në shumën | 12.000 | ( dymbëdhjetë mijë ) lekë |
| 2. | Grisejdi | Bledar | Nauni | në shumën | 25.000 | ( njëzetë e pesë mijë ) lekë. |
| 3. | Jurgen | Aurel | Kole | në shumën | 25.000 | ( njëzetë e pesë mijë ) lekë |
| 4. | Adenis | Adrian | Gele | në shumën | 25.000 | ( njëzetë e pesë mijë ) lekë. |
| 5. | Kloert | Aurel | Kole | në shumën | 25.000 | ( njëzetë e pesë mijë ) lekë |
| 6. | Klajdi | Klodian | Cullufe | në shumën | 16.000 | ( gjashtëmbëdhjetë mijë )lekë |
| 7. | Enea | Hysen | Nurka | në shumën | 16.000 | ( gjashtëmbëdhjetë mijë ) lekë |

8. Joan Ilirjan Tanuci në shumën 12.000 ( dymbëdhjetë mijë ) lekë

9. Zamir Leonard Elmazi në shumën 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë

10. Shejla Pelivan Bajrami në shumën 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë

11. Lorinda Lorenci Turabi në shumën 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë

12. Damian Bilbil Malkë në shumën 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë

13. Qani Neki Hoxha në shumën 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë

14. Endri Adriatik Telha në shumën 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë

15. Aleksandër Klodian Shaho në shumën 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë

16. Adriana Lahe në shumën 50.000 ( pesëdhjetë mijë ) lekë

17. Brunilda Lulo në shumën 10.000 ( dhjetë mijë) lekë

18. Dashnor Pelushaj në shumën 10.000 (dhjetë mijë ) lekë

19. Eranda Dedenikaj në shumën 10.000 (dhjetë mijë ) lekë.

20. Shpresa Jaupi në shumën 10.000 (dhjetë mijë ) lekë.

21. Medine Malkë në shumën 25.000 (njëzetë e pesë mijë ) lekë.

2. Miratimin e transferimit buxhetor si më poshtë :

Pakësim në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 609,Kod Produkti V494AAA në shumën 341 000 lekë

Shtesa në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 606,Kod Produkti V494AAA në shumën 341.000 lekë

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Sektori i Buxhet Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet,më 20.01.2025

# RELACION

# DREJTUAR

# KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Në bazë të kërkesës nga Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare " Meleq Gosnishti " Përmet Nr.469 Prot datë 06.09.2024 e cila kërkoi të ndimohen nga ana financiare 8 ( tetë ) nxënësit e zonave rurale që frekuentojnë shkollën,pasi kosto e transoprtit me gjithë rimbursimin nga ZVAP është e papërballueshme, si dhe kërkesës së bërë nga shkolla 1 Maji Piskovë për të ndihmuar 7 ( shtatë ) nxënësit e zonave rurale që frekuentojnë shkollën nga bashkia është marrë vendimi për rimbursimin e transportit të këtyre nxënësve për periudhën Shtator- Dhjetor 2024 Me fillimin e vitit 2025 bashkia do rimbursojë transportin e nxënësve për periudhën Janar-Maj 2025 për arësye se transporti i këtyre nxënësve ka hasur vështirësi financiare në raport me kërkesat e shoferëvë të mjeteve të cilët kanë shtuar koston e pagesës për orët e pasdites.

Edhe shtetësia Adriana Lahe ka paraqitur kërkesë Nr.130 Prot datë 16.01.2025 pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht pasi kërkon rimbursimin e transportit për djalin e saj Ilvano Lahe i cili frekuenton Qëndrën Komunitare të Fëmijëve me aftësi ndryshe.

Shtetësja Brunilda Lulo ka bërë kërkesë Nr.75 Prot datë 13.01.2025 pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht pasi është e sëmurë,e vetmuar dhe nuk ka mundësi të përballojë shpenzimet për blerjen e ilaçeve.

Shtetësi Dashnor Pelushaj kërkon të ndimohet financiarisht nga bashkia me kërkesë Nr.76 Prot datë 13.01.2025 pasi është i sëmurë dhe nuk i përballon dot shpenzimet për blerjen e ilaçeve,dhe jemi në gjendje të vështirë ekonomike si familje.

Edhe shtetësja Eranda Dedenikaj ka bërë kërkesë pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht ,pasi bashkëshorti i saj vazhdon kimioterapi dhe shpenzimet për kurimin e tij janë të mëdha.

Shtetësja Shpresa Jaupi ka bërë kërkesë pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht ,pasi bashkëshorti i saj vazhdon kimioterapi dhe shpenzimet për kurimin e tij janë të mëdha si dhe trajtohet me KEMP.

Edhe shtetësja Medine Malkë ka bërë kërkesë pranë bashkisë për tu ndimuar financiarisht ,pasi i ka ngordhur lopa dhe nuk ka mundësi për të blerë një tjetër.

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " ,Ligjin Nr. 68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ",Ligjin 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë "i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financjar dhe kontrollin" i ndryshuar, Ligji Nr.115/2024 "Për Buxhetin e vitit 2025",,VKB Nr.107 datë 18.12.2024 " Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, Vendim Nr. 89, datë 14.02. 2018 Për Miratimin e Kushteve dhe përcaktimin e Rregullave për Transportin Rrugor të Nxënësve të Arsimit Parashkollor, Profesional, Parauniversitar dhe të Studentëve, kërkojmë nga ana juaj të merret në considerate vazhdimi ,për dhënie ndihmë financiare për nxënësit që frekuentojnë këto shkolla për periudhën Janar – Maj 2025.

Agathi Altin Dako; frekuenton linjën Qilarisht-Përmet-Qilarisht e cila do përfitoje 12.000 ( dymbëdhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar – Maj ,viti shkollor 2024-2025

Joan Ilirjan Tanuci, frekuenton linjën Qilarisht-Përmet-Qilarisht i cili do përfitoje 12.000 ( dymbëdhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025

Grisejd Bledar Nauni; frekuenton linjën Bënjë-Përmet-Bënjë i cili do përfitojë 25.000 ( njëzetë e pesë mijë ) lekë; për periudhën Janar- Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Jurgen Aurel Kole; frekuenton linjën Bënjë-Përmet-Bënjë i cili do përfitojë 25.000 ( njëzetë e pesë mijë ) lekë; për periudhën Janar- Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Adenis Adrian Gele, frekuenton linjën Bënjë-Përmet-Bënjë i cili do përfitojë 25.000 ( njëzetë e pesë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Kloert Aurel Kole; frekuenton linjën Bënjë-Përmet-Bënjë i cili do përfitojë 25.000 ( njëzetë e pesë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Klajdi Klodian Cullufe; frekuenton linjën Buhal-Përmet-Buhal i cili do përfitojë 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Enea Hysen Nurka frekuenton linjën Buhal-Përmet-Buhal i cili do përfitojë 16.000 ( gjashtëmbëdhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Zamir Leonard Elmazi frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit, i cili do përfitojë 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Shejla Pelivan Bajrami frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit, e cila do përfitojë 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Lorinda Lorenci Turabi frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit, e cila do përfitojë 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Damian Bilbil Malkë frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit, i cili do përfitojë 10.000 ( dhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Qani Neki Hoxha frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit, i cili do përfitojë 10.000 (dhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Endri Adriatik Telha frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit, i cili do përfitojë 10.000 (dhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Aleksandër Klodian Shaho frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit, i cili do përfitojë 10.000 (dhjetë mijë ) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2024-2025.

Si dhe kërkesat e shtetasve :

1- Adriana Lahe të ndimohet përkatësisht në shumën 50.000 ( pesëdhjetë mijë ) lekë .
2- Brunilda Lulo të ndimohet përkatësisht në shumën 10.000 ( dhjetë mijë) lekë
3- Dashnor Pelushaj të ndimohet përkatësisht në shumën 10.000 (dhjetë mijë ) lekë.
4- Eranda Dedenikaj të ndimohet përkatësisht në shumën 10.000 (dhjetë mijë ) lekë.
5- Shpresa Jaupi të ndimohet përkatësisht në shumën 10.000 (dhjetë mijë ) lekë.
6- Medine Malkë të ndimohet përkatësisht në shumën 25.000 (njezete e pese mijë ) lekë.

Bashkengjitur i gjithë dokumentacioni përkates.

Drejtori Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

**P/VENDIM**

Nr.________Datë ______/____/2025

**PËR MIRATIMIN E"PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR NËBASHKINË PËRMET 2025-2027"**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqiperisë" i ndryshuar, Këshilli Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë"Planin e Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në BashkinëPërmet 2025-2027" sipas dokumentit bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë;Drejtoria e Përfshirjes Sociale,Arsimit,Kulturë,Sport; Drejtoria e Financës dhe buxhetit; Burimet Njerëzore sipas strukturës organizative dhe përgjegjësisë së tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**
**ALMA HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**RELACION**

**PËR MIRATIMIN E"PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR NËBASHKINË PËRMET 2025-2027"**

Në vitin 2015, gjatë periudhës së ndryshimeve politike në Shqipëri, u ndërmorën reforma të rëndësishme që preknin strukturën e Bashkive në vend. Këto ndryshime organizative sollën krijimin e 61 Bashkive të reja, duke sjellë me vete sfida të shumta administrative dhe organizative. Këto transformime u realizuan në përpjekje për të decentralizuar më tej pushtetin lokal dhe për të përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Në lidhje me arsimin parashkollor, Bashkia Përmet mori përsipër përgjegjësinë për zbatimin dhe përmirësimin e këtij sektori në territorin e saj. Pas një eksperience pune tetë vjeçare në ofrimin e shërbimit të Arsimit Parashkollor, tashmë duke njohur mirë nevojat dhe sfidat Bashkia Përmet, ka punuar për një plan të qartë afatmesëm për përmirësimin në vijim të shërbimit për të adresuar nevojat dhe sfidat në kopshte.

Procesi i hartimit të Planit të Përmirësimit të shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Përmet (në vijim refreruar si Plani) është mbështetur nga Projekti "Bashki të Forta" i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sëiss Development & Cooperation) i zbatuar nga Helvetas, përmes asistencës teknike të ofruar nga Smart Processes shpk.

> *Qëllimi i planit është të përmirësojë cilësinë e arsimit parashkollor në Bashkinë Përmet, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin.*

Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij. Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vendosjen e objektivave specifike për secilin proces dhe përcaktimin e treguesve të performancës për t'u përdorur për monitorim. Në pjesën e tretë, paraqitet buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren për rritjen e cilësisë së arsimit parashkollor.

Plani është shtrirë në të gjitha kopshtet nën juridiksionin e Bashkisë Përmet dhe do të monitorohet nga Drejtoria e Arsimit të Bashkisëme qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore parashkollore për të gjithë fëmijët në këtë zonë.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Përmet përqendrohet në Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve në kopshte dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme. Objektivat kryesore të planit përfshijnë rritjen e regjistrimeve dhe frekuientimit në kopshte të vajzave dhe djemve, fuqizimin e strukturave të kopshteve dhe sigurimin e një shpërndarje të barabartë të fëmijëve. Në një periudhë tre vjeçare, Plani prezanton sfidat dhe mundësitë specifike të regjistrimit të fëmijëve, duke përfshirë nevojën për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe për të përdorur teknologjinë për të përmirësuar menaxhimin e të dhënave. Lista e aktiviteteve përfshin projekte si punësimi i specialistëve për arsimin parashkollor, vlerësimin e brendshëm kopshteve, themelinin dhe funksionalizimin e organizmave të institucionit arsimor si bordi i kopshtit, këshilli i prindërve, Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin dhe prindërit për të përmirësuar shërbimin.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit synon të adresojë Proceset Kryesore dhe të përmirësojë shërbimin për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi të kufizuara në kopshtet publike të Bashkisë Përmet. Qëllimi kryesor është të rritet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi më i mirë i këtyre rasteve në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i plotë për fëmijët në nevojë.

Për të arritur këtë qëllim, plani ka disa objektiva të përgjithshëm, si rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimi i procesit të menaxhimit të këtyre rasteve. Në mënyrë specifike, për të adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, plani synon të përmirësojë procesin e diagnostikimit të tyre dhe të sigurojë infrastrukturë të përshtatshme në kopshte për t'i bërë ata të aksesueshëm.

Në të njëjtën kohë, plani përfshin ndihmë të përditshme për të gjithë fëmijët në nevojë, përfshirë mbështetje ushqimore, trajtim psikologjik, si dhe ndërhyrje ligjore në rastet e nevojshme. Përveç kësaj, synohet edhe hartimi dhe zbatimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes strukturave të shërbimit social të përfshira për të garantuar një trajtim të drejtë dhe të efektshëm për të gjithë fëmijët në nevojë.

Planifikimi dhe zbatimi i Proceseve Mbështetëse në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Përmet është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët. Këto procese janë themelore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve dhe sigurimin e materialeve didaktike. Qëllimi i Proceseve Mbështetëse është të ofrojnë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në kopshte. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët.

Për të arritur këtë qëllim, objektivat kryesore përfshijnë plotësimin e standardeve të vendosura nga ligji për stafin e kopshteve, rikonstruksionin e godinave të kopshteve për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurimin e materialeve didaktike për të përmbushur nevojat e zhvillimit të fëmijëve. Në procesin e rekrutimit të stafit, janë parashikuar veprime specifike si punësimi i drejtorëve të kopshteve për të përmbushur standardin e një drejtori për çdo 5 grupe fëmijësh, duke respektuar udhëzimet ligjore.Gjithashtu, është parashikuar trajnimi i stafit për situata emergjente dhe për përdorimin e teknologjisë së informacionit, nëpërmjet bashkëpunimit me agjencitë përkatëse për sigurimin e trajnimeve të nevojshme.Për rikonstruksionin e godinave, janë identifikuar nevojat konkrete të kopshteve, duke përfshirë rikonstruksionin e tualeteve,

rinovimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, si dhe sigurimin e materialeve të nevojshme për këtë qëllim.Në planifikimin e nevojave për materiale, është parashikuar hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar një standard të përshtatshëm për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve në kopshte.

Këto masa synojnë të sigurojnë një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe cilësor përtë gjithë fëmijët, vajza e djem, duke përmbushur nevojat e tyre të edukimit dhe zhvillimit në mënyrë efektive.

Zbatimi i Planit do të kërkojë buxhet shtesë të nevojshëm për të realizuar të gjitha projektet e përfshira në Planin e Përmirësimit të Shërbimit. Buxheti shtesë përfshin fusha të ndryshme, duke përfshirë arsimin bazë dhe arsimin parashkollor, si dhe programe për kujdesin social të familjeve, fëmijëve dhe personave të sëmurë apo me aftësi të kufizuara: përkatësisht për vitin 2025:100,890,000 lekë, për vitin 2026: 78,468,000 lekë, për vitin 2027: 83,773,000 lekë.

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqiperisë" i ndryshuar, paraqesim projekt vendimin për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në bashkinë Përmet.

**Konceptoi :Drejtor i Arsimit Parashkollor**

**Margarita Tetollari**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

Përmet më , ___/___/ 2025

**INFORMACION**
**Nr._____ datë____.___.2025**
**PËR**

**NJOHJEN E KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET ME TARIFAT E MIRATUARA NGA ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Me shkresën Nr.409/9 Prot datë 04.12.2024 protokolluar me tonën me Nr.3268 Prot datë 10.12.2024 Bashkia Përmet është njohur me vendimin Nr.47 datë 02.12.2024 të Këshillit Kombëtar Rregullator për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale UK Gjirokastër sh.a.

Pas njohjes me projekt vendimin e nisur nga Komisioni Kombëtar Rregullator mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë , Bashkia Përmet me shkresën Nr.2834/1 kërkon rishikimin e tarifave volumetrike për shërbimin e FU dhe KUN për klientët familjarë si dhe diferencimin e tarifave ndërmjet zonës urbane dhe zonës rurale (njësit administrative ) për Bashkinë Përmet . Komisioni Kombëtar Rregullator vlerësoi tarifat e propozuara dhe mori në konsideratë kërkesën e Bashkisë Përmet për diferencimin e tarifave të klientëve familjarë të zonës urbane dhe rurale për shërbimet e furnizimit me ujit , arriti në konkluzionin se sipas analizës së kryer tarifat janë të bazuara dhe në zbatim të kritereve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara , nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik.

Bashkëlidhur po ju vëmë në djeni dhe për njohje vendimin e miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator dhe tabelën krahasimore të çmimeve për shërbimet e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellësit Kanalizimeve Gjirokastër për Njësinë Përmet.

Ju faleminderit !

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

Sheshi "Abdyl Frashëri" ,tel 35581322254 e-mail info@bashkiapermet.gov.al www.bashkiapermet.gov.al

Tabela 1: Krahesimi i çmimeve per sherbimet e Shoqerise Rajonale te Ujesjelles Kanalizimeve Gjirokaster per Njesine Permet

*Pas vendimit Nr 47 date 02.12.2024 te Entit Rregullator te Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Largimit e Perpunimit te Ujrerave te Ndotura*

*Komisioni Kombetar Rregullator*

| | | Tarifa e furnizimit me uje | | | Tarifa e sherbimit per ujerat e ndotura | | | Tarife fikse sherbimi | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Ishte Leke/m3* | *Behet Leke/m3* | ***Diferenca Leke/m3*** | *Ishte Leke/m3* | *Behet Leke/m3* | ***Diferenca Leke/m3*** | *Ishte* | *Behet* | ***Diferenca*** |
| **Njesia Permet** | Konsumatore Familjar Qyteti Permet | 40 | 50 | **10** | 6 | 15 | **9** | 100 | 200 | **100** |
| | K.F ne Njesite Administrative | 33.33 dhe 16.7 (25 mesatar) | 30 | **5** | 5 dhe 2.5 (3.75 mesatar) | 15 | **11.25** | 100 | 200 | **100** |
| | | | | | | | | | | |
| | Konsumatore Publik Qyteti Permet | 110 | 110 | **0** | 16.5 | 20 | **3.5** | 100 | 300 | **200** |
| | K.Publik ne Njesite Administrative | 41.67 | 60 | **18.33** | 6.25 | 20 | **13.75** | 100 | 300 | **200** |
| | | | | | | | | | | |
| | Konsumatore Privat Qyteti Permet | 120 | 120 | **0** | 18 | 20 | **2** | 200 | 300 | **100** |
| | K.Privat ne Njesite Administrative | 41.67 | 60 | **18.33** | 6.25 | 20 | **13.75** | 200 | 300 | **100** |

REPUB. SEKRETARIA BASHKIA PERMET

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMITTË UJËRAVE TË NDOTURA**

**DREJTORIA TEKNIKO EKONOMIKE**

Nr. 4091/1 prot. Tiranë, më 04.12.2024

**Lënda:** Dërgohet vendimi për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale UK Gjirokastër sh.a.

**SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A**

**GJIROKASTËR**

**AGJENCISË KOMBËTARE UJESJËLLËS KANALIZIMEVE (AKUK)**

**TIRANË**

**BASHKISË GJIROKASTËR**

**GJIROKASTËR**

**BASHKISË TEPELENË**

**TEPELENË**

**BASHKISË MEMALIAJ**

**MEMALIAJ**

**BASHKISË PËRMET**

**PËRMET**

**BASHKISË KËLCYRË**

**KËLCYRË**

**BASHKISË DROPULL**

**DROPULL**

**BASHKISË LIBOHOVË**

**LIBOHOVË**

Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 47, datë 02.12.2024, vendosi të miratojë tarifat për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale UK Gjirokastër sh.a.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator për nivelin e ri të tarifave për shoqërinë Rajonale UK Gjirokastër sh.a.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**FATIME IMERAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

Nr. 4091/2 .prot Tiranë, më 02/12.2024

VENDIM

Nr. 47, datë 02 .12. 2024

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR sh.a

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 *"Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"*, i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021 *"Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime"*(**Vendim KKRR nr.539**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator**

Në mbledhjen e datës 02.12.2024 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

**Konstaton se:**

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a. me shkresën nr. 1864 prot. datë 27.06.2024, me lëndë "Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura" ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës kanalizime sipas tabelës nr.1 të mëposhtme:

SEKRETARIA - BASHKIA PËRMET

*Tabela 1: Tarifat Aktuale dhe të Propozuara nga Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër për vitet 2025-2027.*

| Kategoria e Konsumatorëve | | | A. Shërbimi i FU | | B. Shërbimi i KUN | | D. Tarifë Fikse Shërbimi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Tarifat Aktuale | Tarifat e Propozuara Viti 2025-2027 | Tarifat Aktuale | Tarifat e Propozuara Viti 2025-2027 | Tarifat Aktuale | Tarifat e Propozuara Viti 2025-2027 |
| A. Shërbimi i FU | | | Lek/m$^3$ | Lek/m$^3$ | Lek/m$^3$ | Lek/m$^3$ | Lek/m$^3$ | Lek/m$^3$ |
| Njësia Gjirokastër | Gjirokastër | 1. Konsumatorë Familjarë | 46 | 50/55/60 | 11 | 15 | 100 | 200 |
| | | 2. Konsumatorë Publik | 133 | 133 | 18 | 20 | 100 | 400 |
| | | 3. Konsumatorë Privat | 138 | 138 | 18 | 20 | 100 | 400 |
| | Njësitë Administrative | 1. Konsumatorë Familjarë | 25 | 30 | | | 80 | 200 |
| | | 2. Konsumatorë Publik | 60 | 110 | | | 80 | 400 |
| | | 3. Konsumatorë Privat | 60 | 120 | | | 80 | 400 |
| Njësia Tepelenë | Njësia Tepelenë | 1. Konsumatorë Familjarë | 33 | 50 | 12 | 15 | 90 | 200 |
| | | 2. Konsumatorë Publik | 100 | 110 | 20 | 20 | 400 | 400 |
| | | 3. Konsumatorë Privat | 120 | 120 | 20 | 20 | 250 | 400 |
| Njësia Përmet | Njësia Përmet | 1. Konsumatorë Familjarë | 40/ 33.33* /16.7* | 50/ 55 /60/30 | 6/5/2.5* | 15 | 100 | 200 |
| | | 2. Konsumatorë Publik | 110/ 41.67* | 133 | 16.5/6.25* | 20 | 100 | 400 |
| | | 3. Konsumatorë Privat | 120/ 41.67* | 138 | 18/6.25* | 20 | 200 | 400 |
| Njësia Memaliaj | Njësia Memaliaj | 1. Konsumatorë Familjarë | 33 | 50 | 12 | 15 | 90 | 200 |
| | | 2. Konsumatorë Publik | 100 | 110 | 20 | 20 | 400 | 400 |
| | | 3. Konsumatorë Privat | 120 | 120 | 20 | 20 | 250 | 400 |
| Njësia Këlcyrë* | Njësia Këlcyrë | 1. Konsumatorë Familjarë | 37 | 50 | | 15 | 100 | 200 |
| | | 2. Konsumatorë Publik | 80 | 110 | | 20 | 100 | 400 |
| | | 3. Konsumatorë Privat | 100 | 120 | | 20 | 100 | 400 |
| Njësia Libohovë* | Njësia Libohovë | 1. Konsumatorë Familjarë | 26.3/36.2 | 30 | | 15 | 250 | 200 |
| | | 2. Konsumatorë Publik | 70 | 110 | | 20 | | 400 |
| | | 3. Konsumatorë Privat | 90 | 120 | | 20 | | 400 |
| Njësia Dropull* | Njësia Dropull | 1. Konsumatorë Familjarë | 23 | 30 | | | | 200 |
| | | 2. Konsumatorë Publik | 56 | 110 | | | | 400 |
| | | 3. Konsumatorë Privat | 26 | 120 | | | | 400 |

** Tarifa të pa miratuara nga ERRU, por të vendosura sipas vendimeve të këshillave bashkiak përkatëse.*

2. Me vendimin nr. 20, datë 09.07.2024, "Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Gjirokastër sh.a.", Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të SHRUK Gjirokastër.

3. Kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Gjirokastër sh.a për vendosjen e nivelit të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në Vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, i ndryshuar.

Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër aplikon tarifat e miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese sipas:

- Vendimit të KKRR Nr. 7, datë 08.02.2019 "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Gjirokastër sh.a.
- Vendimit të KKRR Nr. 42, datë 30.07.2010 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a.UK Tepelenë";
- Vendimit të KKRR Nr. 23, datë 30.04.2013 "Për miratimin e tarifave të shërbimit të kanalizimeve për sha U Tepelenë"
- Vendimit të KKRR Nr. 47, datë 30.12.2013 Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha UK Tepelenë".
- Vendimit të KKRR Nr. 34, datë 11.12.2012 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha U Përmet.

4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

   a) Nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale.

   b) Aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale ndër vite.

   c) Përmirësim i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU dhe KUN si rezultat i investimeve të parashikuara.

   d) Tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

5. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në Vendimin e KKRR nr.539, datë 30.12.2021, i ndryshuar, ERRU ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit.

6. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Rajonale Gjirokastër sh.a e kritereve të mëposhtme:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve nga çmimet monopol dhe mbrojtjen e interesave të tyre në lidhje me cilësinë, efiçencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës" të ndryshuar, sa i takon mos lejimit të abuzimit me pozitën dominuese në treg, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve, pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë, pengesat në hyrje në tregun përkatës dhe konkurrencën potenciale;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 *"Për mbrojtjen e Konsumatorëve"* të ndryshuar;

d) Kërkesave të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 *"Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"*.

e) Orientimin e tarifave drejt mbulimit të Kostove Operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

f) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

7. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU ka vendosur detyra për t'u realizuar nga UK Rajonale Gjirokastër sh.a:

a. T'i kushtohet vëmendja maksimale instalimit të matësave në prodhim për të gjithë burimet, si dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrihet objektivi i vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;

b. Të kryejë vlerësimin e "Ujit të Prodhuar" bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës;

c. Të trajnojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të Bilancit të Ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;

d. Të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eleminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;

e. Për aplikimin tarifor të rradhës (jo më vonë se qershor 2027), duke qenë se shoqëria në fund të periudhës rregullatore 2025-2027 do të arrijë të mbulojë mbi 100% kostot O&M, në këtë aplikim të pritshëm shoqëria do të aplikojë sipas metodës "Çmim Tavan" të metodologjisë së tarifave, i cili kërkon që të jetë detyrimisht i shoqëruar me Planin e Biznesit 5-vjeçar i aprovuar paraprakisht nga ERRU. Për këtë qëllim shoqëria duhet të ketë parasysh që brenda vitit 2027 të ketë përditësuar Planin e Biznesit 5-vjeçar duke përdorur si vit bazë të dhënat e çertifikuara të vitit 2026, i cili duhet të shoqërohet me planet përkatëse të veprimit të mbështetura me projekte dhe me burimet e financimit.

f. Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e inestimeve në të ardhmen e afërt në

mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cënimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet.

g. Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2026, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës.

h. Me mbështetjen e Task Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa on-line dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë.

i. Treguesi i eficensës së stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri.

j. Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të këtyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi eficencën e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.

8. Në mbledhjen e datës 23.10.2024 Komisioni Kombëtar Rregullator konkludoi mbi projektvendimin për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Referuar analizës tekniko - ekonomike, ERRU e gjen të justifikuar kërkesën e shoqërisë për ndryshimin e nivelit tarifor, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria.

9. Me shkresën nr. 407 dhe me shkresën nr. 416, datë 24.10.2024, me lëndë "Mbi aplikimin për nivel të ri tarifor të shoqërisë Rajonale UK Gjirokastër" ERRU ka përcjellë për komente projektvendimin e shoqëruar me relacionin përkatës pranë shoqërisë UK Rajonale Gjirokastër, AKUK, Autoritetit të Konkurrencës dhe bashkive Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj, Dropull dhe Libohove.

10. Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër me shkresën nr. 3034/1 prot, datë 31.10.2024 me lëndë "Shprehje mendimi në lidhje me projektvendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale ujësjellës kanalizime Gjirokastër sh. a dhe AKUK me shkresën nr. 3197/1 prot, datë 08.11.2024", me lëndë " Kthim përgjigje", kanë përcjellë dakordësinë e tyre mbi projektvendimin e KKRR. Bashkia Përmet me shkresën nr. 2834/1 me lëndë "Kthim përgjigje" kërkon rishikimin e tarifave volumetrike për shërbimin e FU dhe KUN për klientët familjarë si dhe diferencim të tarifave të klientëve familjar të FU dhe KUN ndërmjet zonës urbane dhe zonës rurale (njësitë administrative) për bashkinë Përmet. Gjithashtu Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr.705/3 prot, datë 11.11.2024, ka dërguar rekomandimet përkatëse mbi projektvendimin.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me Vendim nr. 539, datë 30.12.2021 *"Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime"* i ndryshuar, dhe mori në

PUBLIKA E SHQIPËRISË

Konsideratë kërkesën e bashkisë Përmet, për diferencimin e tarifave të klientëve familjar të zonës urbane dhe rurale për shërbimin e furnizimit me ujë, arrin në konkluzionin se sipas analizës së kryer, tarifat janë të bazuara dhe në zbatim të kritereve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, *"Për mbrojtjen e Konkurrencës"*, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 *"Për mbrojtjen e Konsumatorëve"*.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 *"Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"*, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a si më poshtë:

*Tabela 2. Tarifat e miratuara nga ERRU për shoqërinë Rajonale UK Gjirokastër*

| Njësitë | | Kategoria e Klientëve | Tarifat e Vendosura nga ERRU për periudhën 2025-2027 |
|---|---|---|---|
| ZONA A | Njësia Gjirokastër | **A. Shërbimi i FU** | **Lek/m³** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 50 |
| | | 2. Klientë Publik | 133 |
| | | 3. Klientë Privat | 138 |
| | | **B. Shërbimi i KUN** | **Lek/m³** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 15 |
| | | 2. Klientë Publik | 20 |
| | | 3. Klientë Privat | 20 |
| | | **D. Tarifë Fikse Shërbimi** | **Lek/muaj/lidhje** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 200 |
| | | 2. Klientë Publik | 300 |
| | | 3. Klientë Privat | 300 |
| | Njësia Përmet | **A. Shërbimi i FU** | **Lek/m³** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 50 |
| | | 2. Klientë Publik | 110 |
| | | 3. Klientë Privat | 120 |
| | | **B. Shërbimi i KUN** | **Lek/m3** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 15 |
| | | 2. Klientë Publik | 20 |
| | | 3. Klientë Privat | 20 |
| | | **D. Tarifë Fikse Shërbimi** | **Lek/muaj/lidhje** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 200 |
| | | 2. Klientë Publik | 300 |
| | | 3. Klientë Privat | 300 |
| ZONA B | Njësia Tepelenë | **A. Shërbimi i FU** | **Lek/m³** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 50 |
| | | 2. Klientë Publik | 100 |
| | | 3. Klientë Privat | 120 |

| Zona | Njësia | Shërbimi | Tarifa |
| --- | --- | --- | --- |
| | | **B. Shërbimi i KUN** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 15 |
| | | 2. Klientë Publik | 20 |
| | | 3. Klientë Privat | 20 |
| | | **D. Tarifë Fikse Shërbimi** | **Lek/muaj/lidhje** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 200 |
| | | 2. Klientë Publik | 400 |
| | | 3. Klientë Privat | 300 |
| | Njësia Memaliaj | **A. Shërbimi i FU** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 50 |
| | | 2. Klientë Publik | 100 |
| | | 3. Klientë Privat | 120 |
| | | **B. Shërbimi i KUN** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 15 |
| | | 2. Klientë Publik | 20 |
| | | 3. Klientë Privat | 20 |
| | | **D. Tarifë Fikse Shërbimi** | **Lek/muaj/lidhje** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 200 |
| | | 2. Klientë Publik | 400 |
| | | 3. Klientë Privat | 300 |
| | Njësia Këlcyrë | **A. Shërbimi i FU** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 50 |
| | | 2. Klientë Publik | 100 |
| | | 3. Klientë Privat | 100 |
| | | **B. Shërbimi i KUN** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 15 |
| | | 2. Klientë Publik | 20 |
| | | 3. Klientë Privat | 20 |
| | | **D. Tarifë Fikse Shërbimi** | **Lek/muaj/lidhje** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 200 |
| | | 2. Klientë Publik | 300 |
| | | 3. Klientë Privat | 300 |
| ZONA C | Njësia Libohovë | **A. Shërbimi i FU** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 30 |
| | | 2. Klientë Publik | 70 |
| | | 3. Klientë Privat | 90 |
| | | **B. Shërbimi i KUN** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 15 |
| | | 2. Klientë Publik | 20 |
| | | 3. Klientë Privat | 20 |
| | | **D. Tarifë Fikse Shërbimi** | **Lek/muaj/lidhje** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 200 |
| | | 2. Klientë Publik | 300 |
| | | 3. Klientë Privat | 300 |
| | Njësia Dropull | **A. Shërbimi i FU** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | 30 |
| | | 2. Klientë Publik | 60 |
| | | 3. Klientë Privat | 60 |
| | | **B. Shërbimi i KUN** | **Lek/m$^3$** |
| | | 1. Klientë Familjarë | - |


PUBLIKA E SH
PERISË

| | | |
|---|---|---|
| | 2. Klientë Publik | - |
| | 3. Klientë Privat | - |
| | **D. Tarifë Fikse Shërbimi** | **Lek/muaj/ lidhje** |
| | 1. Klientë Familjarë | 200 |
| | 2. Klientë Publik | 300 |
| | 3. Klientë Privat | 300 |
| Njësitë Administrative-Gjirokastër, Përmet | **A. Shërbimi i FU** | **Lek/m³** |
| | 1. Klientë Familjarë | 30 |
| | 2. Klientë Publik | 60 |
| | 3. Klientë Privat | 60 |
| | **B. Shërbimi i KUN*** | **Lek/m³** |
| | 1. Klientë Familjarë | 15 |
| | 2. Klientë Publik | 20 |
| | 3. Klientë Privat | 20 |
| | **D. Tarifë Fikse Shërbimi** | **Lek/muaj/ lidhje** |
| | 1. Klientë Familjarë | 200 |
| | 2. Klientë Publik | 300 |
| | 3. Klientë Privat | 300 |

** Tarifat për shërbimin e kanalizimeve gjatë periudhës 2025-2027 do të aplikohen vetëm për Njësitë Administrative të Bashkisë Përmet.*

2. Objektivat e Treguesve të Performancës në fund të vitit 2026 të vendosura nga ERRU janë:

***Tabela 3: Objektivat e Treguesve të Performancës (TKPs)***

| TKP | Nr. | Emri i TKP-ve | Njësia TKP | Objektivat e vendosura nga ERRU në fund të Vitit 2026 |
|---|---|---|---|---|
| **Mbulimi me shërbim** | 1.1 | Mbulimi me shërbimin e FU | % | 93.91 |
| | 1.2 | Mbulimi me shërbimin me KUN | % | 29.37 |
| **TKP Teknike** | 2.1 | Uji Pa të Ardhura | % | 37 |
| | 3 | Niveli i Matjes | % | **90** |
| | 4 | Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë | orë/ditë | **22** |
| | 5.1 | Efikasiteti i Energjisë për ujin | kWh/m³ | **0.24** |
| | 6 | Eficenca e stafit | nr/nr/1000 banorë | 2.16 |
| **Shërbimi ndaj klientit** | 7.1 | Ankesat e Klientëve | % | 2.25 |
| | 7.2 | Ankesat e Klientëve që kanë marrë përgjigje | % | 100 |
| | 7.3 | Ankesat e Klientëve që kanë marrë zgjidhje | % | **4.42** |
| **TKP Financiare** | 8.1 | Norma Korrente e Arkëtimit | % | **80** |
| | 8.2 | Norma e Përgjithshme e Arkëtimit | % | **105** |
| | 9.2 | Mbulimi i Kostove O&M | % | **102** |

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh. a. do të jetë 0.77% e të ardhurave të parashikuara nga aktiviteti sipas analizës tekniko ekonomike.

[illegible] Rajonale Gjirokastër sh.a detyrohet të nënshkruajë kontratën "Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU dhe shlyerjen e pagesës rregullatore" brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

5. Ky vendim hyn në fuqi me datë 01.01.2025 dhe është i vlefshëm deri në 31.12.2027.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYETARE**

**Evis SHURDHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

**P/VENDIM**

**Nr.____ datë ____/____2025**

**PËR**
**NJOHJEN ME MARRËVESHJEN NR.72 DATË 13.01.2025, MIDIS SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR DHE BASHKISË PËRMET DHE IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT "PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË".**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", Ligjin Nr.115/2024"Për buxhetin e vitit 2025", VKB Nr.107 datë 18.12.2024 "Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025"; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024 ,midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet ,në zbatim të projektit «Përqafimi i shpresës , një oaz për ata që kanë nevojë», Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Njohjen me marrëveshjen Nr.72 datë 13.01.2025, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet.
2. Implementimi i projektit "Përqafimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë", referuar Marrëveshjes Nr.72 datë 13.01.2025 dhe buxhetit të projektit për vitet 2025-2027 si mëposhtë:

Për vitin 2025:

| **Përshkrimi i buxhetit** | **Vlera** | **Financim Fondi Social** | **Financim Bashkia Përmet** |
|---|---|---|---|
| *Pagat dhe kostot e stafit* | 921 946 lekë | 921 946 lekë | |
| *Bashkëfinancimi në asete, vlerë monetare, burime njerëzore* | 1 528 269 lekë | | 1 528 269 lekë |
| ***Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)*** | | | |
| Mallra(produkte ushqimore) | 4 380 000 lekë | 4 380 000 lekë | |
| Mallra (produkte higjenike) | 120 000 lekë | 120 000 lekë | |
| Aktivitete social-kulturore | 60 000 lekë | 60 000 lekë | |
| Hartimi i materialeve promovuese | 22,000 lekë | 22,000 lekë | |
| | | **78%** | **22%** |

Për vitin 2026:

| Përshkrimi i buxhetit | Vlera | Financim Fondi Social | Financim Bashkia Përmet |
|---|---|---|---|
| *Pagat dhe kostot e stafit* | 921 946 lekë | 921 946 lekë | |
| *Bashkëfinancimi në asete, vlerë monetare, burime njerëzore* | 1 528 269 lekë | | 1 528 269 lekë |
| ***Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)*** | | | |
| Mallra(produkte ushqimore) | 4 380 000 lekë | 3 200 000 lekë | 1 180 000 lekë |
| Mallra (produkte higjenike) | 120 000 lekë | 80 000 lekë | 40 000 lekë |
| Aktivitete social-kulturore | 60 000 lekë | 15 000 lekë | 45 000 lekë |
| Hartimi i materialeve promovuese | 22,000 lekë | | 22,000 lekë |
| | | **60%** | **40%** |

Për vitin 2027:

| Përshkrimi i buxhetit | Vlera | Financim Fondi Social | Financim Bashkia Përmet |
|---|---|---|---|
| *Pagat dhe kostot e stafit* | 921 946 lekë | | 921 946 lekë |
| *Bashkëfinancimi në asete, vlerë monetare, burime njerëzore* | 1 528 269 lekë | | 1 528 269 lekë |
| ***Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)*** | | | |
| Mallra(produkte ushqimore) | 4 380 000 lekë | 2 100 000 lekë | 2 280 000 lekë |
| Mallra (produkte higjenike) | 120 000 lekë | | 120 000 lekë |
| Aktivitete social-kulturore | 60 000 lekë | | 60 000 lekë |
| Hartimi i materialeve promovuese | 22,000 lekë | | 22,000 lekë |
| | | **30%** | **70%** |

3. Vlerës së buxhetit i shtohet dhe vlera 10% sipas indeksimit në bazë të inflacionit nga Instituti Statistikave.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financë, Drejtoria e Projekteve, Integrimit Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave dhe Drejtoria e Shërbimit Social.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga prefektura

**KRYETAR I BASHKISË**
**ALMA HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254,e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

*Përmet, më 22.01.2025*

**RELACION**

**PËR**
**NJOHJEN ME MARRËVESHJEN NR.72 DATË 13.01.2025, MIDIS SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR DHE BASHKISË PËRMET DHE IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT "PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË".**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", Ligjin Nr.115/2024"Për buxhetin e vitit 2025", VKB Nr.107 datë 18.12.2024 "Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025"; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024 ,midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet ,në zbatim të projektit «Përqafimi i shpresës , një oaz për ata që kanë nevojë», po ju paraqesim informacion për projektin për të cilin është nënshkruar marrëveshja Nr.72 Prot datë 13.01.2025 midis Bashkisë Përmet dhe Shërbimit Social Shtetëror:

**1. Projekti «Përqafimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë»**

Bashkia Përmet ka ndërmarrë një hap për ngritjen e Qendrës ditore për të moshuarit, ku ka vënë në dispozicion një ambient me kushte të përshtatshme ku të moshuarit kalojnë kohën e lirë në shoqërinë e njëri –tjetrit duke shërbyer dhe kafe ose caj për frekuentuesit.
Më pas ka nisur ofrimin e shërbimit në banesë për 16 të moshuar të vetmuar të cilët marrin kujdes shëndetësor dhe psikologjik nga staf infermier dhe psikolog , kjo në kuadër të zbatimit të projektit me UNDP.

Megjithatë kjo nuk është e vetmja kategori për të cilën mungon vëmendja në ofrimin e shërbimeve, gjithashtu Njësia e Referimit dhe Vlerësimit të rastit në Bashkinë Përmet ka identifikuar individë në situatë vulnerabël, individë me probleme social-ekonomike, persona me aftësi të kufizuar të braktisur, jetimë dhe persona të pastrehë apo pjesë e Komunitetit Egjyptian. Këto kategori kanë vështirësi sociale dhe ekonomike.

Pikërisht këtu nisi ideja e projektit tonë për të ngritur një Qendër ditore për ofrimin e shërbimeve sociale specifike dhe 1 vakt ushqimor duke rritur përfshirjen sociale të këtyre kategorive dhe përmirësuar situatën sociale të tyre. Ideja e projektit tonë bazohet në Planin e Kujdesit Social të Bashkisë Përmet 2024-2027, qëllimi i projektit tonë është: Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit dhe llojeve të shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë. (Qëllimi 2 në planin social).

EPUBLIKA E SHQIPËR

Një problematikë tjetër është mungesa e aktiviteteve sociale-kulturore për këto kategori duke sjellë mungesë të përfshirjes në jetën social-kulturore të qytetit.
Për situatat e vështira që këta individë ndodhen është menduar disa herë krijimi i një ambienti të përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve të ndryshme sociale duke filluar nga ofrimi i një vakti ushqimor. Pamundësitë financiare nuk kanë mundur që kjo nismë të realizohej. Bashkia Përmet tashmë ka krijuar një ambient pranë Qendrës së Qytetit të dedikuar për të moshuarit ku mund të argëtohen dhe të kalojnë kohë në shoqërinë e njëri-tjetrit. Megjithatë kjo nuk zgjidh shqetësimin tonë më të madh që është mbështetja për kategori të ndryshme vulnerabël.
Nëpërmjet këtij projekti, Bashkia Përmet ka krijuar një ambient prej dy dhomash pranë Konviktit Përmet, duke e mobiluar dhe përshatur si nje Qendër ditore multifunksionale e cila do ti shërbejë jo vetëm kategorive që do të marrin shërbim social 1 vakt ushqim por në orët e pasdites kjo Qendër të funksionojë për argëtim të të moshuarve që jetojnë në lagjen Mejden (pasi Qendra Ditore e të moshuarve është pak larg me lagjen ku ata banojnë). Kjo Qendër ditore do të shërbejë për informimin e kategorive që do ta frekuentojnë në lidhje me shërbimet lehtësuese në bashki, mbështetje psikologjike, shoqërore, organizim të aktiviteteve të ndryshme me qëllim përfshirjen në jetën social-kulturore.

**Periudha e implementimit:** Janar 2025- Dhjetor 2027(36 muaj)

**Buxheti total i projektit:** 22 192 168.9 lekë

| | |
|---|---|
| **Kostot Totale** | 22,192,168.9 lekë |
| Kontributi i kërkuar | 13,002,981.2 lekë |
| Kontributi i vet | 9,189,187.7 lekë |

**Donatori:** Programi i Fondit Social, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Qëllimi i projektit**: Përmirësimi i qasjes në shërbime sociale përmes rritjes së numrit dhe llojeve të shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë.

**Objektivat e Projektit**:

*Objektivi* 1: Të ngrihet dhe të vihet në funksion qendra ditore e të moshuarve duke ofruar shërbime për të moshuarit dhe grupet në nevojë. (Shërbimet do të ofrohen për të moshuarit e vetmuar, personat me aftësi të kufizuara, personat në situatë vulnerabiliteti të shumëfishtë.) Objektivi 2.3 në Planin Social
*Objektivi* 2: Të rrisë përfshirjen sociale të moshës së tretë dhe grupeve në nevojë në qytetin e Përmetit nëpërmjet realizimit të aktiviteteve social-kulturore.

**Ndërhyrjet kryesore të parashikuar në projekt janë:**

**Rezultatet e lidhura me objektivin 1:**
***Funksionimi i qendrës ditore, ofrimi i shërbimeve sociale dhe 1 vakt ushqimor për këtë kategori.***
Rezultati 1.1: 30 persona përfshirë të moshuar të vetmuar dhe persona të tjerë në situatë vulnerabiliteti marrin shërbim një vakt ushqimor.
Rezultati 1.2: 30 persona marrin shërbim social (mbështetje psikologjike, kujdes shoqëror, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet ).
Rezultati 1.3: Të paktën 50 persona informohen për shërbimet sociale lehtësuese që ofrohen në Bashkinë Përmet.
Rezultati 1.4: Të paktën 50 persona marrin pjesë në aktivitetet artistike-kulturore të organizuara.
Rezultati 1.5: Të paktën 20 të rinj i bashkohen nismës "1 ditë vullnetar".
Rezultati 1.6: Të paktën 20 të moshuar kanë një ambient të dedikuar për të kaluar kohën e lirë.

**Rezultatet e lidhura me objektivin 2:**
***Realizim i aktiviteteve që nxisin pjesmarrjen dhe përfshirjen e moshës së tretë në qytetin e Përmetit.***
Rezultati 2.1: Realizimi i aktivitetit "Krijojmë kujtime".
Rezultati 2.2: Realizimi i aktivitetit "Sporti dhe shëndeti" 6 Prill Dita Botërore e Sportit.
Rezultati 2.3: Realizimi i eventit " Mirënjohje " 1 Tetori.
Rezultati 2.4: Realizimi i aktivitetit 1 film në Kinema.

- Fondi social do të mbështesë

i) 78% të kostos për vitin e parë të ofrimit të shërbimeve;
ii) 60% të kostos për vitin e dytë të ofrimit të shërbimeve;
iii) 30% të kostos për vitin e tretë të ofrimit të shërbimeve

- Bashkëfinancimi i Bashkisë Përmet është :

iv) 22% të kostos për vitin e parë të ofrimit të shërbimeve(kosto stafi);
v) 40% të kostos për vitin e dytë të ofrimit të shërbimeve;
vi) 70% të kostos për vitin e tretë të ofrimit të shërbimeve

Sipas Marrëveshjes plani i pagesave është si mëposhtë:

***Për vitin 2025:***

| Përshkrimi i buxhetit | Vlera | Financim Fondi Social | Financim Bashkia Përmet |
|---|---|---|---|
| *Pagat dhe kostot e stafit* | 921 946 lekë | 921 946 lekë | |
| *Bashkëfinancimi në asete, vlerë monetare, burime njerëzore* | 1 528 269 lekë | | 1 528 269 lekë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ***Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)*** | | | |
| Mallra(produkte ushqimore) | 4 380 000 lekë | 4 380 000 lekë | |
| Mallra (produkte higjenike) | 120 000 lekë | 120 000 lekë | |
| Aktivitete social-kulturore | 60 000 lekë | 60 000 lekë | |
| Hartimi i materialeve promovuese | 22,000 lekë | 22,000 lekë | |
| | | **78%** | **22%** |

***Për vitin 2026:***

| **Përshkrimi i buxhetit** | **Vlera** | **Financim Fondi Social** | **Financim Bashkia Përmet** |
|---|---|---|---|
| *Pagat dhe kostot e stafit* | 921 946 lekë | 921 946 lekë | |
| *Bashkëfinancimi në asete, vlerë monetare, burime njerëzore* | 1 528 269 lekë | | 1 528 269 lekë |
| ***Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)*** | | | |
| Mallra(produkte ushqimore) | 4 380 000 lekë | 3 200 000 lekë | 1 180 000 lekë |
| Mallra (produkte higjenike) | 120 000 lekë | 80 000 lekë | 40 000 lekë |
| Aktivitete social-kulturore | 60 000 lekë | 15 000 lekë | 45 000 lekë |
| Hartimi i materialeve promovuese | 22,000 lekë | | 22,000 lekë |
| | | **60%** | **40%** |

***Për vitin 2027:***

UBLIKA E SHQIPËRIS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

| Përshkrimi i buxhetit | Vlera | Financim Fondi Social | Financim Bashkia Përmet |
|---|---|---|---|
| *Pagat dhe kostot e stafit* | 921 946 lekë | | 921 946 lekë |
| *Bashkëfinancimi në asete, vlerë monetare, burime njerëzore* | 1 528 269 lekë | | 1 528 269 lekë |
| ***Shpenzimet për aktivitete (sipas planit të punës)*** | | | |
| Mallra(produkte ushqimore) | 4 380 000 lekë | 2 100 000 lekë | 2 280 000 lekë |
| Mallra (produkte higjenike) | 120 000 lekë | | 120 000 lekë |
| Aktivitete social-kulturore | 60 000 lekë | | 60 000 lekë |
| Hartimi i materialeve promovuese | 22,000 lekë | | 22,000 lekë |
| | | **30%** | **70%** |

Vlerës së buxhetit i shtohet dhe vlera 10% sipas indeksimit në bazë të inflacionit nga Instituti Statistikave.

**Faleminderit**
**Drejtoria e Projekteve të Huaja/Integrimit Evropian/ Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave**

**Klaudja Ciko**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr______ date_____/____/2025**

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PERFITUESËVE DHE MASËN E SUBVENCIONIT TË INTERESAVE PËR INDIVIDE/FAMILJE QË PERFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI PËR KUOTAT E MIRATURA PËR BASHKINË PËRMET.

Ne mbështeje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 24, pika 2, Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" neni 2 pika 24, neni 15, pika 5, neni 47, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore" pika 18, Vendimit nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti" pika 26, shkresës së Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit Nr.15406 prot., datë 06.12.2024 "Mbi programin e subvecionimin e interesave të kredise", VKB nr.115 date: 18/12/2024 "Per miratimin e sistemit te pikezimit per kredi te lehtesuara nga shteti per vitin 2025 ne Bashkine Permet"(*Tabela aneksi 2*), në kuadër të programit të kredisë së lehtësuar për strehim me 3%, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni konsultativ i strehimit dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë :

VENDOSI

1- Të miratojë **listën e përfitueseve** dhe masën e subvencionimit te interesave të kredise për individe/familje që perfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti për **kuotat e miratura për 10 familje për Bashkinë Përmet** sipas listes 1 bashkëngjitur këtij Vendimi dhe është pjesë përberëse e tij.

2- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit dhe Specialisti Strehimit.

3- Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes.

**KYETARE E BASHKISË**

**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA PËRMET**

LISTA E PERFITUESËVE DHE MASËN E SUBVENCIONIT TË INTERESAVE PËR INDIVIDE/FAMILJE QË PERFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI PËR KUOTAT E MIRATURA PËR BASHKINË PËRMET

**LISTA 1, e 10 famileve përfitueseve per masën e subvencionimit te interesave të kredise për Bashkine Përmet.**

| Nr | Emeri/Atesia/Mbiemeri | Perberja familjare | Strktura e apartamentit qe perfiton | Kushtet e strehimit (shkronja "a" e nenit 16) | Kushtet familjare (shkronja "b" e nenit 16) | Kushtet sociale (shkronja "c" e nenit 16) | Kushtet ekonomike | Total piket | Te ardhurat mujore neto te familjes | Punesimi | Kufiri maksimal i kredise qe perfiton familja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **7** | | | **8** | **9** | **10** |
| | | | | | | | | | | | |
| 1 | Adriana Stiljanos Cicolli | 4 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 51,708 | *shtet* | 2,794,500 |
| 2 | Erion Hasan Qamo | 4 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 60,382 | *privat* | 2,794,500 |
| 3 | Arsilda Vladimir Makri | 3 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 3 | 14 | 87,777 | *privat* | 2,794,500 |
| 4 | Sokol Shahin Mehmeti | 5 | 3+1 | 6 | 5 | 0 | 3 | 14 | 128,501 | *shtet* | 3,450,000 |
| 5 | Eraldo Vangjel Dhimitri | 4 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 117,723 | *privat* | 2,794,500 |
| 6 | Frederika Hodo Jani | 6 | 3+1 | 6 | 5 | 0 | 3 | 14 | 93,120 | *shtet* | 3,450,000 |
| 7 | Fiorent Agim Jace | 3 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 10 | 21 | 88,256 | *privat* | 2,794,500 |
| 8 | Besnik Sulo Rama | 5 | 3+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 269,500 | *shtet/privat* | 3,450,000 |
| 9 | Maria Nuredin Ilia | 4 | 2+1 | 6 | 3 | 4 | 5 | 18 | 80,000 | *privat* | 2,794,500 |
| 10 | Elvis Vangjush Naqe | 3 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 50,009 | *shtet* | 2,794,500 |

**BASHKIA PERMET**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

REPUBLIKA E SHQIP

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA PERMET

***ZYRA E SHERBIMEVE PUBLIKE***

# RELACION

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PERFITUESËVE DHE MASËN E SUBVENCIONIT TË INTERESAVE PËR INDIVIDE/FAMILJE QË PERFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI PËR KUOTAT E MIRATURA PËR BASHKINË PËRMET.

**Drejtuar**: Këshillit Bashkiak Përmet

Ne mbështeje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 24, pika 2, Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" neni 15, pika 5, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore" pika 18, Vendimit nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti" pika 26, shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.18627prot., datë 17.10.2019 "Mbi projektin për subecionimin e interesave te kredise" VKB nr.5 date 25/01/2023 "Per miratimin e sistemit te pikezimit per kredi te lehtesuara nga shteti per vitin 2023 ne Bashkine Permet" në kuadër të programit të kredisë së lehtësuar për strehim me interes 3%,

***1)Të dhëna të përgjithëshme në lidhje me programin:***

Programi Social i Strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë" synon të mbështesë në blerjen e banesave me kosto te ulet , me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës se qytetareve per kategori të caktuara sipas ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" duke ofruar mundesine e blerjes se baneses me ane te instumentit financiar "Subecionimi i interesave të kredise". ***Ne baze te shkresës së Ministrisë së Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit Nr.15406 prot., datë 06.12.2024 "Mbi programin për subvecionimin e interesave te kredise" Bashkia Permet ka te drejten e dergimit ne listen te nje nr prej 10 familjeve. Per kerkesat mbi kete nr ngelen ne liste pritje.***

Kriteret bazë për paraseleksionimin e kërkesës së paraqitur nga individët/familjet e interesuara për të përfituar nga programi social i strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë", janë:

- ✓ individë të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mbushur moshën 18 vjeç;
- ✓ familjet të cilët në momentin e paraqitjes së kërkesës nuk kanë në pronësi një banesë;
- ✓ familjet që zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit;
- ✓ familjet që zotërojnë të ardhura brënda kufijve të përcaktuar.

Perparesi ne vleresimin e aplikimeve:

- ✓ ndividët e rinj dhe familjet që kanë në përbërje një çift të ri
- ✓ Familjet e mesme, duke patur parasysh që në fund të kredisë mosha e aplikantëve të mos jetë më shumë se 65 vjeç

***a ) Për të dhëna personale të aplikantit:***

EPUBLIKA E SHQIPËR

i. certifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
ii. vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.
iii. Të ketë aplikuar ne sistemin e strehimit.

***b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":***

i. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (Zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Permet) për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;
ii. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (Zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Permet) për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi;
iii. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës (Zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Permet) se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
iv. vërtetim nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës që aplikanti apo çdo pjestar tjetër i familjes në moshë madhore nuk ka aplikuar për legalizim banese. (origjinale)
v. aktverifikim nga njësia vendore për:
   a. banesat në rrezik shembjeje;
   b. rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
   c. banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.
vi. vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
vii. akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.

***c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës "b", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":***

i) certifikatë familjare;
ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

***ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës "c", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":***

i. vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;
ii. vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;
iii. dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;
iv. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";
v. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe

EPUBLIKA E SHQIPËRI

Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;

vi. urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;

vii. vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;

viii. dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;

ix. vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë.

***d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës "ç", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":***

i. vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

ii. dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;

iii. vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;

iv. vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;

v. vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

vi. Kontratë qiraje.

**dh)** ***Kufiri Maksimal i Kredisë/ Familje miratuar per Bashkine Permet.***

| Struktura familjare nr i personave | Nr max i familjeve perfitueseve ne Bashkine Permet | Struktura apartamentit | Kufiri maximal i kredisë/familje |
|---|---|---|---|
| 1-2 | 14 | Garsoniere | 1 552 500 |
| 3 | | 1+1 | 1 897 500 |
| 4 | | 2+1 | 2.795.500 |
| 5-6 | | 3+1 | 3.450.000 |

**2- Te dhena te aplikueseve:**

Aplikimi nga qytetaret eshte realizuar nepermjet :

*a-* Sistemit te strehimit ne portalin qeveritar *e-albania* ne rubriken "*Kerkese per te perfituar nga programet e strehimit social*".

b- Nepermjet zyra e sherbmit te qytetarir (One Stop Shop)

c- Kerkesat e paraqitura ne Bashki sipas tabeles me poshte:

| Nr | Emeri/Atesia/Mbiemeri | Perberja familjare |
|---|---|---|
| **1** | **2** | **3** |
| | | |
| 1 | Adriana Stiljanos Cicolli | 4 |
| 2 | Erion Hasan Qamo | 4 |
| 3 | Arsilda Vladimir Makri | 3 |

REPUBLIKA E SHQIPERI

| | | |
|---|---|---|
| 4 | Sokol Shahin Mehmeti | 5 |
| 5 | Eraldo Vangjel Dhimitri | 4 |
| 6 | Frederika Hodo Jani | 6 |
| 7 | Fiorent Agim Jace | 3 |
| 8 | Besnik Sulo Rama | 5 |
| 9 | Maria Nuredin Ilia | 4 |
| 10 | Elvis Vangjush Naqe | 3 |

**d- Vlerësimi i komisionit per Aplikuesit e listes per 10 familje:**

1- Aplikanti: **Adriana Cicolli** datlindja 21/02/1995, perberja familjare 3 persona (cift/1 F) K/familjari i papune, b/shortja punësuar në shtet, banojne me qera ne qytetin Permet, nuk kane pasuri te paluajteshme referuar vertetimit hipotekor ASHK Permet. Të ardhurat totale mujore të familjes: 51 708 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 2 794 500 leke.

2- Aplikanti: **Erion Hasan Qamo** Datëlindja: 23/11/1980 përberja familjare 4 persona (cift/2 F). Bashkeshorte te vetepunesuar, Të ardhurat totale mujore të familjes: 60 382 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 2 794 500 lek.

3- Aplikuesi **Arsilda Vladimir Makri** e datlindjes 26/02/2000 F Bashkëshortja përberja familjare 3 persona (cift/1 F) Bashkëshortet te punesuar në aktivitet privat, Të ardhurat totale mujore të familjes: 87 777 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 2 794 500 lek.

4- Aplikuesi **Sokol Shahin Mehmeti** k/familjar, datëlindja: 20/08/1982, përberja familjare 5 persona (cift/3 F). E bija Ares Mehmeti e datlindjes 29/12/2010 me aftesi te kufizuara, banojne me qera, nuk kane pasuri te paluajteshme referuar vertetimit hipotekor ASHK Permet dt 20.02.2023, bashkeshortet punesuar ne shtet, Të ardhurat totale mujore të familjes: 128 501 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 3 450 000lek.

5- Aplikuesi **Eraldo Vangjel Dhimitri**, i datlindjes 30.08.1991, përberja familjare 4 persona (cift/2 F). Banojne ne banese te mbipopulluar (me prinderit dhe vellai). nuk kane pasuri te paluajteshme referuar vertetimit hipotekor ASHK Permet Eraldo Dhimitri i punesuar ne shtet me page neto 30 192 lek, Vangjel Dhimitri i ati i punesuar ne shtet me page neto 30 192 lek, Nauert Dhimitri i vellai i punesuar ne shtet me page neto 57 339 lek, Nena pension invaliditeti. Të ardhurat totale mujore të familjes: 117 723 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 2 794 500 lek.

6- Aplikuesi **Frederika Hodo Jani** e datlindjes 15.06.1990 perberja familjare 6 persona (cift/1F/e reja/nip/mbese) banon ne banese me qera me adrese: Qyteti Permet, bashkeshortet nuk kane pasuri te paluajteshme referuar vertetimit hipotekor ASHK Permet bashkeshorti i punesuar ne shtet me page 60 750 lek bashkeshortja e punesuar ne shtet me page 32 370 lek. Të ardhurat totale mujore të familjes: 93 120 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 3 450 000 lek.

7- Aplikuesi **Fiorent Agim Jace** k/familjar, datëlindja: 05.02.1995, përberja familjare 3 persona (cift/1 F), banojne me qera, nuk kane pasuri te paluajteshme referuar vertetimit hipotekor ASHK Permet, bashkeshortet punesuar ne privat, Të ardhurat totale mujore të familjes: 88 256 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 2 794 500 lek.

8- Aplikuesi **Besnik Sulo Rama** k/familjar, datëlindja: 01.12.1971, përberja familjare 5 persona (cift/3F), banojne ne mjedise qe nuk plotesojne kushtet e strehimit, nuk kane pasuri te paluajteshme referuar vertetimit hipotekor ASHK Permet, kryefamiljari punesuar ne shtet, bashkeshortja punesuar ne aktivitet privat, femijet te punesuar ne aktivite privat.Të ardhurat totale mujore të familjes: 269 500 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 3 45 000 lek.

9- Aplikuesi **Maria Nuredin Ilia** e datlindjes 12.08.1964 perberja familjare 4 persona cift/2F) banon ne banese me qera me adrese: Nr.nd 0, Rr. QENDRORE 02270031; Nd. 138; H. 1,

REPUBLIKA E SHQIPERIS

PËRMET. Punesuar ne privat. Të ardhurat totale mujore të familjes: 80 000 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 2 794 500 lek.

10- Aplikuesi **Elvis Vangjush Naqe,** k/familjar, datëlindja: 17/11/1988, përberja familjare 3 persona (cift/1F), banojne me qera ne adresen: Nr.nd 0, Rr. ELENA GJIKA 02240026; Nd. 16; H. 1; Ap. 5; PËRMET;. nuk kane pasuri te paluajteshme referuar vertetimit hipotekor ASHK Permet, bashkeshortja punesuar ne shtet, Të ardhurat totale mujore të familjes: 50 009 Lek. Vlera max e masës së përfitimit të kredisë 2 794 500 lek.

**Tabela nr 1 e vleresimit sipas sitemit te pikezimit:**

| Nr | Emeri/Atesia/Mbiemeri | Perberja familjare | Strktura e apartamentit qe perfiton | Kushtet e strehimit (shkronja "a" e nenit 16) | Kushtet familjare (shkronja "b" e nenit 16) | Kushtet sociale (shkronja "c" e nenit 16) | Kushtet ekonomike | Total piket | Te ardhurat mujore neto te familjes | Punesimi | Kufiri maksimal i kredise qe perfiton familja |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | | | 8 | 9 | 10 |
| | | | | | | | | | | | |
| 1 | Adriana Stiljanos Cicolli | 4 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 51,708 | *shtet* | 2,794,500 |
| 2 | Erion Hasan Qamo | 4 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 60,382 | *privat* | 2,794,500 |
| 3 | Arsilda Vladimir Makri | 3 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 3 | 14 | 87,777 | *privat* | 2,794,500 |
| 4 | Sokol Shahin Mehmeti | 5 | 3+1 | 6 | 5 | 0 | 3 | 14 | 128,501 | *shtet* | 3,450,000 |
| 5 | Eraldo Vangjel Dhimitri | 4 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 117,723 | *privat* | 2,794,500 |
| 6 | Frederika Hodo Jani | 6 | 3+1 | 6 | 5 | 0 | 3 | 14 | 93,120 | *shtet* | 3,450,000 |
| 7 | Fiorent Agim Jace | 3 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 10 | 21 | 88,256 | *privat* | 2,794,500 |
| 8 | Besnik Sulo Rama | 5 | 3+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 269,500 | *shtet privat* | 3,450,000 |
| 9 | Maria Nuredin Ilia | 4 | 2+1 | 6 | 3 | 4 | 5 | 18 | 80,000 | *privat* | 2,794,500 |
| 10 | Elvis Vangjush Naqe | 3 | 2+1 | 6 | 5 | 0 | 5 | 16 | 50,009 | *shtet* | 2,794,500 |

**Përfundime:**

Duke marrë parasysh edhe sugjerimet Tuaja të aprovojmë listen nr 1 per perfituesit per programet e strehimit socila "subveionimi i intresave te kredise" si me poshte:

1- Miratimin e 10 familje të pastreha, **sipas listes 1** me qellim qe ketyre familjeve t'ju jepet mundesia per te perfituar nga programet e socile te strehimit, banese me kosto te ulet, per perfitimin e kredise se lehtesuar nga shteti.
2- Mbas miratimit ne Keshillin e Bashkise te ketyre lisave, keto do tju dergohen institucioneve kredituese: Bankave te nivelit te pare, Raiffeisen Bank, Intesa Sanpaolo Bank, Banka Kombetare Tregetare (BKT), si edhe Ministrise se Financave dhe Entit Kombetar te Banesave.

*BASHKIA PERMET*

**Komisioni Konsultativ i strehimit:**

Kryetar Aulona Meshini

Anëtar Arian Jaupi

" " Arjana Papapano

" " Jurgen Simoni

" " Pavlina Hormoviti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA PËRMET

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA PËRMET**

## PROJEKT - VENDIM

## NR.______DATË____________
## PËR
## VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE TË BASHKISË PËRMET PËR VITET 2026-2028

Në mbështetje të neneve 8,9,34-37,54, shkronja "f", 55 pika 3 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", kreu III ,nenit 34 pika 1-3 të Ligjit nr.68/2017 "Për finanacat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008" Për menaxhimin e sitemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar , Ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financjar dhe kontrollin ", i ndryshuar , Udhëzimin nr.7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave "Për proçedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm ",Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**VENDOSI:**

I. Të miratojë vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmet për vitet 2026-2028 sipas dokumentit bashkëlidhur.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë Drejtoritë/ Sektorët pranë Bashkisë Përmet dhe Njësitë Administrative

III.Ky vendim hyn në fuqi 10( dhjetë ) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I BASHKISË**
**Alma HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

**RELACION**

**Vlerësimi dhe parashikimi afat mesëm i të ardhurave të veta të Bashkisë Përmet 2026-2028**

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhura bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara ngaLigji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Planifikimi i te ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Përmet, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Paketa fiskale e Bashkisë Përmet për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh dhe të vogël, banorë vetë njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit, këshilltarë etj., pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore /kufi, etj. Sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Politikat incentivuese në taksa:

- Taksë 0 (zero) ndërtese për qëllime banimi për invalidët kryefamiljarë.
- Taksë 0 (zero)për familjet e pensionisteve të vetmuar.

Politikat incentiveuese dhe uljet nën nivelet e kostos së sherbimit të llogaritur:

- Tarifa e pastrimit 0 (zero) për familjet me ndihmë ekonomike.
- Tarifa e pastrimit 0 (zero) për familjet e pensionisteve të vetmuar.
- Tarifa të reduktuara 50% sipas kritereve për pensionistë, invalidë, etj.
- Tarifa 0 (zero) për familjet me kryefamiljarë invalidë, veteranë e të verbër.
- Subjektet të cilët do të punësojnë mbi 30 persona përjashtohen një vit nga tarifat vendore.

Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet e Agjentët tatimorë, etj. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e

mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksiontë zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorin e bashkisë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burimet e tjera.

Zërat e taksave dhe tarifave qe ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta ne vitin 2026 qe perkon dhe me vitin buxhetor per vitin e ardhshem, janë kryesisht tarifat për pastrimin që zë rreth 19.4% të tij, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 20.6%, taksa e ndikimit në ifrastrukturë që zë rreth 11.6%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 7,6%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 7,5%, tarifa e gjelbërimit që zë rreth 4,3 %, tarifa për kullot je bagëti e që zë rreth 2.7 %. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 71 % të planit të të ardhurave të Bashkisë Përmet.E njejta situate paraqitet pak a shume edhe per dy vitet e tjera planifikuese .Administrata e Bashkisë ka pasur parasysh që në ndryshimet e paraqitura për zërat e të ardhurave që lidhen me pasurinë e paluajtshme ( takes trualli, takes ndërtese dhe taksa e tokës bujqësore )do të ndikojë zgjerimi i bazës së taksa paguesve nëpërmjet:

- Saktësimit dhe vlerësimit të drejtës i përfaqësuese nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë,
- Ndarjes në këstet e pagesave, ( për taksën e ndërtesës për popullatën )
- shtrirje e mëtejshme e bazës taksa paguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksa paguesin, si dhe bashkëpunimit të pritshëm me institucionin ASHK.

Ndryshimi në zërin e Taksës së ndikimit në infrastrukture paraqet potencialin për dhënien e lejeve të ndërtimit pas hartimit të PPV dhe kërkesave të paraqitura deri më tani.

Për sa i takon tarifave te tjera vendore nuk janë paraqitur ndryshime esenciale në parashikimet për vitet 2026-2028

- pasi nga të dhënat statiskore që Zyra e Tatim Taksave ka në arritjet e kapaciteteve paguese ( shtim të familjæ apo të bizneseve ).
- Është bërë ndryshim me rtje për Taksën e Truallit bazuar ne realizimin e vitit 2024 dhe nga zgjerimi i bazës së taapaguesve.
- Është bërë ndryshim mrritje për tarifen e gjelberimit bazuar ne realizimin e vitit 2024,dhe planifikim per tje te sperfaqeve te gjelberta ,hapesira shlodhese ne qytet .

Tabela e më poshtme psyron plnin e të ardhurave të veta, të kategorizuar si pas klasifikimit ekonomik ligjor:

Ju faleminderit!

Pergjegjesi Tatim – Taksave

**Dorjan METKO**

REPUBLIKA E SHQIPE

## ...afatmesme Bashkia Permet vitet 2026-2028

000 lek

| | | | | | Planifikim | Planifikim | Planifikim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Viti 2025 | Viti 2026 | Viti 2027 | Viti 2028 |
| | | 26671 | 24293 | 34125 | 43840 | 44960 | 44980 |
| 1 | Taksa mbi ndertesat | 9251 | 7418 | 12000 | 15000 | 15000 | 15000 |
| 2 | Taksë mbi truallin | 1113 | 1500 | 1700 | 1900 | 1900 | 1900 |
| 3 | Tatim I thjeshtuar mbi fitimin | 286 | 153 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Takse e ndik.infr.nd.reja dhe legalizimet | 3193 | 1331 | 7000 | 10770 | 10780 | 10790 |
| 5 | Takse mbi kalimin e te drejtes se prones. | 201 | 414 | 0 | 1470 | 1480 | 1490 |
| 6 | Takse Rregjistrim automjeti | 5648 | 6282 | 6000 | 7000 | 8000 | 8000 |
| 7 | Takse Tabele | 380 | 301 | 400 | 400 | 400 | 400 |
| 8 | Taksë mbi tokën bujqësore | 1964 | 1653 | 2025 | 2200 | 2200 | 2200 |
| 9 | Taksë fjetje në hotel | 108 | 289 | 500 | 500 | 500 | 500 |
| 10 | Tatim mbi të ardhurat personale | 4527 | 5050 | 4500 | 4600 | 4700 | 4700 |
| B | **TE ARDHURA JOTATIMORE** | **35906** | **31866** | **40740** | **48865** | **55920** | **56145** |
| 1 | Tarife Pastrimi | 14803 | 14284 | 15000 | 18000 | 20000 | 20000 |
| 2 | Tarife Ndricimi | 4359 | 4037 | 5000 | 7000 | 9000 | 9000 |
| 3 | Tarife Gjelberimi | 2080 | 1955 | 2000 | 4000 | 6000 | 6000 |
| 4 | Leje Rregjistrim Veprimtarie | 255 | 1094 | 1500 | 1500 | 1500 | 1500 |
| 5 | Qera Objekti | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Te ardhura nga Cerdhja Kopshti | 2332 | 1831 | 1500 | 2340 | 2345 | 2350 |
| 7 | Tarife Parkimi | 53 | 60 | 500 | 700 | 1000 | 1000 |
| 8 | **Tarifë për lëndë drusore** | 612 | 589 | 825 | 830 | 835 | 840 |
| 9 | Tarifë zënie hapësirë publike | 558 | 1178 | 1200 | 1200 | 1200 | 1200 |
| 10 | Tarifë kullotje bagëtije | 1278 | 1130 | 2500 | 2500 | 2500 | 2500 |
| 11 | Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës | 132 | 233 | 600 | 600 | 800 | 1000 |
| 12 | Të ardhura nga qiraja për troje | 6027 | 2818 | 6540 | 5695 | 5700 | 5700 |
| 13 | Tarifa vendore nga urbanistika | 2021 | 1145 | 2130 | 2140 | 2150 | 2160 |
| 14 | Tarifa shërbimesh të MNZ | 102 | 45 | 135 | 140 | 145 | 150 |
| 15 | Te tjera te ardhura | 1294 | 1467 | 1310 | 2220 | 2745 | 2745 |
| | **Të ardhura vjetore** | **62577** | **56159** | **74865** | **92705** | **100880** | **101125** |

**Pergjegjesi i Tatim-Taksave**

**Dorjan METKO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

## P/VENDIM

Nr._____ datë____.___.2025

**Për Miratimin e Marrëveshjes së Investimit dhe Funksionimit e Mirëmbajtjes ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Përmet për ZIP LINE PËRMET**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji Nr. 10130 datë 11.05.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit" si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

## VENDOSI :

1. Të miratojë ndërtimin projektit Zip Line në pasuritë me Nr.210 Z.K 2419 fshati Lëshice, Nr.560 Z.K 2419 fsha Lëshice, Nr.508 Z.K 2419 fshati Lëshice, Nr.389 Z.K 3115 fshati Qilarisht, Nr.380/2 Z.K3115 fshati Qilarisht, Njësia Administrative Petran, Përmet.

2. Të miratojë marrëvesen e Investimit midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Përmet për Zip Line ...met dërguar nga FSHZH me anë të shkresës Nr.3844 Prot datë 25.10.2024.

3. Të miratojë marrëvesh e Funksionimit dhe Mirëmbajtjes midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkis...rmet për Zip Line Përmet dërguar nga FSHZH me anë të shkresës Nr.3844 Prot da...5.10.2024.

4. Për zbatimin e këtij vendi... arkohet Drejtoria e Urbanistikës/Planifikimit të Territorit/ Sektori Juridik e Prokurime ...ejtoria Financë Buxhet,sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

5. Ky vendim, pas miratimit nga ... këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYE...
...BASHKISË
...HA...

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET

Sheshi "Abdy Frashëri" ;tel.+35581322254 e-mail in... ...rmet.gov.al www.bashkiapermet.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet më , ___.___. 2025

# RELACION

**Nr._____ datë_____.____.2025**

**Për Miratimin e Marrëveshjes së Investimit dhe Funksionimit e Mirëmbajtjes ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Përmet për ZIP LINE PËRMET**

Me anë të shkresës Nr.3844 Prot datë 25.10.2024 Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka shfaqur interes për lidhjen e një marrëveshje investimi ku në kuadër të Projektit të Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit , ka planifikuar të financojë nënprojektin me objekt "Zip Line Përmet".

Objekti i kësaj marrëveshje është financimi i punimeve për realizimin e nënprojektit "Zip Line Përmet".

Ky projekt synon të zhvillojë turizmin dhe të sjellë përfitime për komunitetin .Zip Line do të shtrihet në pasuritë me Nr.210 Z.K 2419 fshati Lëshice , Nr.560 Z.K 2419 fshati Lëshice , Nr.508 Z.K 2419 fshati Lëshice, Nr.389 Z.K 3115 fshati Qilarisht, Nr.380/2 Z.K 3115 fshati Qilarisht, Njësia Administrative Petran , Përmet.

Pershkrimi i objektit :

Objekti i Zip Line përfshin ndërtimin e disa strukturave :
Pika e informacionit, Pika e nisjes, Platforma e Mbërritjes, Parkimi, Shtigje kalimi.

Pika e informacionit: e pozicionuar pranë rrugës kryesore dhe bregut të lumit, drejtimi i saj formon një vijë perpendikulare me platformën e nisjes, duke e bërë këtë të fundit qartësisht të dukshme. Për më tepër, pika informacionit qëndron paralel me platformën e uljes që ofron pamje të njerëzve që marrin Zipline poshtë afër lumit.

Platforma e nisjes ndodhet në shkëmb, duke bërë që te shihet qartë nga rruga. Platforma e fillimit është e orientuar drejt luginës, duke inkuadruar pamjen më të mirë që ofron vendi.

Platforma e uljes ndodhet në anën tjetër të bregut të lumit, 300 m afër urës. Gjithashtu duke ofruar pamje drejt lumit dhe anës tjetër të bregut.

REPUBLIKA E SH
SEKR
BASHK

Shtigjet e kalimit te cilat lidhin Parkimin Nr.1 dhe Info Point me Platformen e fillimit dhe te uljes si dhe shtigjet e kalimit qe lidhin parkimin Nr.2 me Platformen e fillimit.

Gjatësia e Zip Line referuar planimetrisë është 555 ml.

Për ndërtimin e Info Point Parkimit Nr.1 Parkimit Nr.2 Platformës së fillimit dhe të uljes do të vihen ne dispozicion pasuritë Nr.210 Z.K 2419 fshati Lëshice , Nr.560 Z.K 2419 fshati Lëshice, Nr.508 Z.K 2419 fshati Lëshice , Nr.389 Z.K 3115 fshati Qilarisht, Nr.380/2 Z.K 3115 fshati Qilarisht, me status juridik "Shtet".

FSZH Me anë të shkresës Nr.3844 Prot datë 25.10.2024 ka dërguar për shyrtim Marrëveshjen e Investimit dhe të Funksionimit e Mirëmbajtjes.

Marrëveshja e Investimit

Referuar Marrëveshjes së investimit nisur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për Zip Line Bashkia Përmet ka të drejta dhe detyrime të caktuara : miraton Projektin Teknik të nënprojektit që është objekt i kësaj marrëveshje, garanton se trualli i cili preket nga zbatimi i nënprojektit është tokë në pronësi të Shtetit, jep lejen e ndërtimit me zhvillues "Bashkia" duke sjellë përjashtimin nga detyrimi për të paguar taksën e ndikimit në infrastukturë, siguron Autorizimin ose Lejen Mjedisore duke mbuluar fianciarisht tarifën përkatëse, monitoron dhe mbështet Fondin Shqiptar të Zhvillimit që të mbikqyrë në mënyrë aktive punimet .

Marrëveshja e Funksionimit dhe Mirëmbajtjes

Referuar Marrëveshjes së Funksionimit e Mirëmbajtjes disa prej pikave kryesore janë: të hartohet plani i funksionimit dhe mirëmbatjes për një periudhë 5 vjeçare, Bashkia Përmet të hartojë specifikimet teknike, të përfundojë procedurën e prokurimit dhe të kontraktojë një subjekt privat për mirëmbajtjen e nënprojektit për pesë vitet e ardhshme, kostot e kontratës së kërkuar pesë vjeçare të mirëmbajtjes do të përfshihen në buxhetin e Bashkisë Përmet për pesë vitet e ardhshme.

Bashkëlidhur relaconit do të jetë Marrëveshja e Investimit dhe Marrëveshja e Funksionimit dhe Mirëmbajtjes dërguar nga ana e Fondit Shqiptar të Zhvillimit datë 25.10.2024. Gjithashtu bashkëlidhur do të jetë edhe projekti.

**Konceptoi :Zyra Juridike**
**Ketrina Lile**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SEKRETARIA
BASHKIA PERMET